

COLLANA DIRETTA DA FRANCESCO ALTIMARI

ALBANICA

1

RACCONTI POPOLARI

di Falconara Albanese

Raccolti, trascritti e tradotti in italiano
da *P. VINCENZO MALAJ*

Volume edito con il contributo di



Commissione Europea
DG XXII - Progetto BETLA



Università della Calabria
Cattedra di Lingua e Letteratura albanese

Redazione e revisione dei testi
a cura di *Fiorella De Rosa*

Le foto appartengono all'archivio privato di Nicola Carnevale
e risalgono al periodo della registrazione dei materiali qui pubblicati
(Anni '60 del XX Secolo)

INDICE

Tre vëllezërit	3
<i>I tre fratelli</i>	81
Ujku e dhejpëra	5
<i>Il lupo e la volpe</i>	83
Korvi e dhejpëra	6
<i>Il corvo e la volpe</i>	84
Ata ç' bën tata, semble bën mir	7
<i>Quello che fa il padre, fa sempre bene</i>	85
I jati e e bija	9
<i>Il padre e la figlia</i>	87
Ëm pullarin, se t'jap parmëndin	10
<i>Mi ridai l'asino, ti ridò l'aratro</i>	88
Hjugalli	12
<i>Jugale</i>	90
Ujku e pullari	14
<i>Il lupo e l'asino</i>	92
Gjakqumshtja	16
<i>Sanguelatte</i>	94
Zoti Krisht e Shën Pjetri	19
<i>Gesù Cristo e San Pietro</i>	97
Kuleçët, nana, se t'jam mbes	20
<i>Frittelle. Nonna, sono la tua nipotina</i>	98
Ursi e dhejpra	21
<i>L'orso e la volpe</i>	99
Nusja e fatarme	24
<i>La sposa incantata</i>	102
Kostandini e Garandina	27
<i>Costantino e Garentina</i>	105
Tri motrat e ujku	29
<i>Le tre sorelle ed il lupo</i>	107
Tri motrat pjaka	32
<i>Tre vecchie sorelle</i>	110
Trediçini	34
<i>Tredicino</i>	112
Tre llatra	38
<i>Tre ladri</i>	116
Servituri i rregjit e kali i fatatur	40
<i>Il servitore del re ed il cavallo fatato</i>	118

Më i vogli vëlla, llu magu e e bukra e dheut	46
<i>Il fratello minore, il mago e la più bella del mondo</i>	125
Kostandini e Garendina	49
<i>Costantino e Garentina</i>	128
Tri motrat, një vëllath e e bija e rregjit	51
<i>Tre sorelle, un ragazzo e la figlia del re</i>	130
Storia e Fallkunarës	56
<i>La storia di falconara</i>	135
Llatri e kali	58
<i>Il ladro ed il cavallo</i>	137
Gruëja parabullare	59
<i>La moglie pettegolona</i>	138
Dhejpra e korvi	61
<i>La volpe e il corvo</i>	140
Çeku, surdi e guerçi	62
<i>Il cieco, il sordo e lo zoppo</i>	141
Pica	63
<i>La pizza</i>	142
Tre çizat	64
<i>I tre ceci</i>	143
Kostandini i vogëlith	65
<i>Costantino il Piccolo</i>	144
Hjugalli e Zoti Krisht	66
<i>Jugale e Gesù Cristo</i>	146
E jëma e pullarvet	67
<i>La madre dei puledri</i>	147
I biri çë ruan pullarin	68
<i>Il figlio che trattenne l'asino</i>	148
Më mir një cik zjarr se një cik buk	69
<i>Meglio un po' di fuoco che un po' di pane</i>	149
Vistra fjalësh	70
<i>Filastrocca</i>	150
Rregji, servituri e vajza me lesh doratu	71
<i>Il re, il servitore e la ragazza dai capelli dorati</i>	151
Alladini	73
<i>Aladino</i>	153
Proverbi	77
<i>Proverbi</i>	157

Albanese

TRE VËLLEZËRIT

Nji ghër ish nji át ç' kish tre fëmij. Kur ki diqi, të bijvet i la një fik, e këto tre bij ndajtin fikun: një mori nji dég ç'ish më madhe, njetri nji dég ç'ish m'e vogël e më i vogli vëlla mori kurin.

I pari bír, kur ish moti i fiqvet, vate i mbjodhi e vate te nji katund viçino se t'i shitën. Allura vat te ki katund, par se t'arrivarën te ki katund, pá nji pjak. Ki pjak i tha:

“Biri im, ç'jé qellën?” Ki tha:

“Jam e qelli voje deti...!”.

“E voje deti t'u gjënçin!” i tha ki pjak, ç'ish Zoti Krisht. Però ki djál këtu nëng e dij se ish Zoti Krisht. Arrivarën te ki katund e zu e thirri:

“Kush do fiq frisku? Kush do fiq frisku?”

Allura gjith njerzit ván atje. Ván atje e kur pán se in voje deti, muertin e e rraghtin e ki u mbjodh mbu shpitë e nëng i tha faregjë të vëllezërvet.

I diti vëllá vate te fiku puru ai e mbjodhi ca fiq. Mbjodhi e u nis se t' vëj te ki katund viçino se t'i shitën, e te udha pá kët pjak ç'ish sembre Zoti Krisht. Ki pjak i tha:

“Biri im, ç'jé qellën?” Ki i rrispundír, tha:

“Voje deti”.

“E voje deti t'u gjënçin!” i tha ki pjak.

Arrivarti te ki katundi e bëri si i vëllaj.

“Kush do fiq frisku? Kush do fiq frisku?”

E njerzit ván gjith atje. Ván, ván atje, kur pán se nëng ín fiq, u gjëndin voja si të vëllát, e muertin me shkopëra e e rraghtin. Allura ki vate mbu shpitë. Intantu i pari vëllá me të ditin e foltit këta e u vún dakordu se dërgójn puru tjetrin vëllá, më të voglin se kështu rraghtin puru atë e i thán se t' veji e mirr fiq puru ai. Ki vate e mbjodhi fiqët e u ndisët se t' vëj te ki katund viçinu. Par' se t'arrivarën, inkuntrarti kët pjak ç'i tha:

“Biri im, ç'jé qellën?”

Ki i rrispundirti:

“Fiq frisku. Doni?”

E kij tha:

“Më shitën e më aumendarin, më ké”.

E ki vate te ki katund viçinu. Kur zú e thirrën:

“Kush do fiq frisku?! Kush do fiq frisku?!”

Gjith njerzët ván me shkope e me cika se t'e rraghin përçë kredhirin se i fisjarën. Kur ai pá 'ta

“Çë bëni kështu? U ju solla fiq frisku e ju vini t’ m’ rraghni?!

Ata pán fiq frisku vurtét e zún e bjëjtin. Ki më shiten, e ín më shum fiqët. Allora ki bëri shum solldëra. Si bëri shum solldëra, u mbjodhi mbu shpijtë.

Kur e pán të vëllezërit ç’ kish bë shum solldëra, qëndruan líg. “Nani çë mbijmë, nani çë nëng mbijmë...” Intantu ki gjeti një shoqe të mír, u martua e u ki’ sistemartur.

Të vëllezërit, çë in invidjuzëra, allura muartin një kungét e e mbjuën me gjarpëra se t’ bëj t’ vdís kij. Allora ki ish e fjëj me t’ shoqen e nëng di faregjë çë kumbinarin të vëllezërit. Këto muartin kët kungét e ván e e tojtin propriu teku fjëj i vëllai. Kur e tojtën, inçe t’in gjarpëra, u gjëndin më shum solldëra. Kur pán kështu, këta u trëmtin e muërtin e iktin.

I vëllai i vogël mbjodhi solldërat e u sistemár edhè më mír.

Ato ghëngërtin e pijtin e na rrím këtu e ghám eshtrat.

Narratore: Michele Nesci. Paese: Falconara Albanese. Età: 17 anni. Istruzione: II agraria. Genitori: ambedue albanesi. Professione: studente. Data della registrazione: 05/09/1967.

UJKU E DHEJPËRA

Nji ghër nji dhejpër ish e xhirjarën e veje ka nj' án e ka njetra e nëng dij ç' kish t' bën. Arrivarën te nji án e shegh një puc. Allura te kij puc ín dí kate, një ka nj' án e një ka jetër, çë kallارشin posht t' mirri újt. Allura kjo si façarti te puci, vete bije. Vete bije ma u ki rá mbi kat mbi kat e qindroi atjè posht. Qindroi atjè posht ma penzarti:

“Si ka t' bënj se t' ghipem?”

E ish e disperarme, ish... Nëng dij si kish t' bën si të ghipi atjè n' máj. Gjith një gherje nji ujk ç'ishe shkon atéj, arrivarën puru te puci. Arrivarën te puci, allora sa façaret atjè, e shegh dhejprën. I thót:

“Ç'jé bën atí?” i thót dhejprës.

Kjo allora, kur pá kët ujkun, penzarti se t'a bucerár... allura i tha ujkut:

“Ee” tha “këtu ë mish... Jam e ghá këtu...”

“Ë mish?” tha ujku. “E si ë?”

“Ee, këtu ë mish! E puru t' mír ësht... E ka t' jét ndonj lóp ç' vate rá... Ç'i tojtin këtu... Nëng e dí, ma u jam e ghá...”.

I tha ujku:

“E si bënj” tha “se t' vinj t' ghá puru u?”

“E si ka t' bëç?” tha dhejpëra “Vëju te jetri kát e kallaru e kështu ghà puru ti...”

Ujku tha:

“Vurtét” tha “ka t'a bënj një manxhát, përçë nëng ghëngra çëkúr...”

Allura ujku vate te jetri kát. Vate te jetri kát, si bëri tatjè, ai ç'ish më pizante, ujku, kallaret, dhejpëra, ç'ish më llexheru ghipet. Kur pá kështu dhejpra i tha ujkut:

“T' bucerarta!” tha.

E mori e iku e e là ujkun atjè n' puc.

Narratore: Michele Nesci. Paese: Falconara Albanese. Età: 17 anni. Istruzione: II agraria. Genitori: ambedue albanesi. Professione: studente. Data della registrazione: 05/09/1967.

KORVI E DHEJPËRA

Nji korv më nëng kish çë t' gháj. Batoghet në máj ndë nj' arvur e pá një finestër ç'ish ghapët e pá se ish djáth. Allura mori korvi e vullarti e vat' te finestra e mori djathin. Patruni i shpís véj e nëng gjën më djathin e allura thój:

“Ma si ka t' bënj të mund t' kapiri kush është?”

Vate të ditën díť korvi, mori djathin e iku. Dopu u ghip máj te një arvur te kurrinjeli. Shkoi një dhejpër ndën e i tha:

“Ç'jé e ghá?” i tha.

“Jam e ghá nj' cík djáth”.

“Ee, t' shomi ndë ç'jé kapaçe se të këndoç?”

Ai këndoi e djathi i vate rá. Dhejpra e ghapu gojën e tha:

“T' frikarta” tha “djathin e ghëngra u, e ti qëndron pa fare”.

E mori e iku.

Narratore: Pietro Zappa. *Paese:* Falconara Albanese. *Età:* 12 anni. *Istruzione:* IV elementare. *Genitori:* Padre albanese, madre italiana (ma parla albanese). *Professione:* studente. *Data della registrazione:* 07/08/1969.

ATA Ç' BËN TATA, SEMBRE BËN MIR

Një ghér ish një búrr e një grua, ç'ishe martuar me këtë, e kín një animall, kín një lóp. I shoqi i tha t' shoqes:

“Shigh se u ndonj dít vete te fera se t' shiti lopën”.

Kur ish dít e ferës, ki u ndis e shitën lopën. Si ish e kërciën, pá një búrr me një kaval. I tha këtij burri:

“M'e jep at kaval se t' jap lopën?”

“Ëgh” i tha kij “përçë lopa ish e mír e e ndrroi ki búrr”. Ki tha:

“Më mír kavali. Ësht më i mír, m' dighën se t' shurbenj... ka një án e ka njetër... Ë më i mír kavali!”

E ish e kërcëj edhë se t' véj te fera. Par' se t'arrivarën te fera, inkontrarën njetër búrr ç' kish një dele. Penzarti e tha:

“Time shoqe i parír më dela. Çë dela ë një animall më i vogël” tha “barin e ghà, na jep leshtë, dopu na jep qumshtin, bën ndonj qëngj... e ë sembre mír. E mbám viçino, e mbám... Inveçe kavali ë më i madh. Më mír delen...”. E i tha këtí:

“M'e jep delen se t' jap kavalin?”

Ki, kur gjegji kështu tha:

“Ëgh!”

I dha delen e mori kavalin. Ki gjith kundendu ish e vej te fera. Tha:

“Vete llu stesu te fera, kur se kam delen nëng i bën gjë”.

Si ish e vej te fera, inkontrarën një ç' kish një púl. Penzarti pár:

“Pula është e mír, vurtét, bën vét pula... e një vé është e mír është... Dopu me pulën mund kemi zogëza...” E allura ja tha kët:

“Në t' jap kët dele, m'e jep pulën ti?”

Ki kur pá kështu: një dele për një púl, ndrroi. I mori pulën, e vu ndën krahut e ish viçino te katundi t' ferës e arrivarti atjè. Sikome nëng kish të bën faregjë, ghiri ndinján se të gháj në një tratorí. Si ghiri atje, gjegji një adúr të móll t' kalbta, in ca mólla... Allura i tha këtij:

“Ndë t' jap kët púl, m' jep at thes móll?”

E ki, ç'in ca móll t' kalbta e kisht i toji këto, tha:

“Ëgh”.

Mori mollët e i dha pulën e vate u mbijár se t' gháj. Atje viçinu in di ingllizëra. Allura ki ish e kundarën llu fatu, jo se ki bër n'afaru, kish mollët... Kur këto gjegjin kët diskúrs kështu, ju viçinartin atij e i thán:

“Skometirim se kur ti vete mbu shpit, jot shoqe të rraghën”. Ki tha:

“Skometírim!”

“E ndë jot shoqe nëng t’ thotë faregjë”, i thán ingllizët “na t’ japëm aq solldëra sa pizarën ti”.

“Ëgh” tha ki.

“N’ mos t’ rraghim puru na”.

“Ëgh” tha ki “m’ rraghni”.

Dopu çë foltin e ghëgërtin, u ndistin. Ki mori molltë t’ kalbta (intantu ato mollët in e kalbëshin më shum edhè, se i ki’ vën viçinu zjarrit e vín e pucarín ndutu) e u ndistin. U ndistin e dopu një dít, arrivartën mbu shpít. Mbu shpít ish e shoqja. Ki zú e i tha t’ shoqes:

“Kenja lopën e e ndrrova me nj’ kaval”.

“Bëre mír!” i tha e shoqja “Kavali e sembre më i mír se lopa”.

“Ëgh” tha “ma dopu si jenja e kërcenje, puru kaválin e ndrrova... e ndrrova me nj’ dele...”

“Aaa, bëre mír për dele!” rispundirti e shoqja. “Bëre mír vurtet, se dela ë më e vogël, ësht më e mír, dopu na jep lesht, qëngjin, qumshtin... Bëre mír! Bravo!” i tha.

“Ma dopu si kërcenja edhè, pé një ç’ kish një púl... Allura u i dhé delën e mora pulën...”

“Më mír edhè” i tha. “Bëre mír vurtet” i tha, “përçë pula na bën vét, e dopu puru zogëztë... Ësht e mír pula. E bëre mír vurtet”.

“Ma dopu arrivarta mbë katund” tha “ghira ndinján se t’ ghánja e ish një ç’ kish ca móll, këta móll kështu... janë një cík t’ kajbta, ma u i mora llu stesu...”

“Nani meritán vurtet një t’ puthur, përçë jetrën dítë vajta te ajo çë rri viçinu neve, i lipa një móll, e ajo nëng më dha mëngu një móll t’ kajbët... Bëre mír vurtet! E e puthi t’ shoqin...”

Ngëlliztë, kur pán kështu, qëndruan líg, qëndruan me gój ghápt, e allura muërtin aq solldëra sa pizarën ai e ja dhán gjith atij...

Kjo purrallëz do t’ thón se ata ç’ bën tata, sembre bën mír!

Narratore: Michele Nesci. Paese: Falconara Albanese. Età: 18 anni. Istruzione: III agraria. Genitori: ambedue albanesi. Professione: studente. Data della registrazione: 28/08/1968.

I JATI E E BIJA

Ish një ghër i jati e e bija e in t' vetëm, përçë e jëma ki' dekur. I jati véj e shërbín ditën e mbrëmvet véj te një kandín e mbrijakarej e nga mbrëma mbidhej mbu shpít tardu. E bija, ç' kish katër vjet, rriji vetëm mbu shpít, qëndron mbë shtrat e e pritën. Një mbrëma i jati si shkoi, u mbrijakár. Mori e vete mbu shpit. E bija i tha t' jatit:

“Papà, ma përçë nëng mbidhij më njize pa fare mbrijakartur?”

I jati i tha:

“Ma u ditën shurbenj e ndo' pa' ghër ka t' pij púr...”

E bija i tha t' jatit:

“Ti mbidhe nga mbrëma mbrijakartur”.

“Va bene” tha i jati “t' gjegji tij. Nesër mbrëma vetëm mbrijakarem e dopu ngë mbrijakarem më”.

E bija pënzarti se mbrëmvet mírr një qirí e e pritën t' jatin me dritën te shkalla, se kështu ai ndë ç' vjen e silli mbu shpit. E kështu bëri. Si i jati ish e mbidhij, pá se ish një dritë te skallunet. Tha:

“Ma kush është ajo vájz?”

U viçínár e ajo vájz i thirri:

“Tát! Eja se jam u!”

Mori i jati e tha:

“O bija ime, t' thaç se kjo ish ll'ulltima ghër, e ll'ulltima ghër është, përçë u t' pé se ti më do vurtèt mír e më pritën te shkalla se t' mos bije.

Ghitën mbrënda e dopu ç' at mbrëma i jati nëng u mbrijakár më”.

Narratore: Pietro Zappa. Paese: Falconara Albanese. Età: 12 anni. Istruzione: IV elementare. Genitori: Padre albanese, madre italiana (ma parla albanese). Professione: studente. Data della registrazione: 07/08/1969.

ËM PULLARIN, SE T'JAP PARMËNDIN

Te një mal in dí shpí e atjè rrijin dí famije me ca njerz. Një ghér një burr ka këta kish t' vej te një katund. Si kish një parmënd e nëng dij ku kish t'e vëj, mori e ja la gjitonit t'ja mbáj, përçë bun véjn lladrit e ja marrin. Gjitori tha:

“Ëgh, t'e vijonj!” E e mori.

Kur u mbjodh, vate te gjitori nd'i jip parmëndin:

“Ëm atë parmëndin se u mbjodha”.

Gjitori ç'ja ki vijuar i tha:

“Rú, ka t' më skuzariç, ma e vura te katoj, e mijt e ghëngërtin... E kin grën ndonullat...”

Ki jetri qëndroi me goj ghapët, përçë mijt ngë mun kin ngrën parmëndin. Ma kur pá kështu i tha:

“Ghekuri nëng ghaghet! Ti do t' fisjáriç?”



Famiglia benestante falconarese degli inizi del '900

Ki ç'ja ki mbajtur i tha:
“Jore, se është vurtet! Epúr t’ thom se mijt e ghëngërtin...”
Ki vate u mbjodh, edhe nëng ish sikúr për ata ç’i tha gjítoni.
Njatër ghér kij gjíton ç’i kish vjedhur parmëndin jetrit, kish t’ vej e bën nj’ mbashát te një katund. Mori pullarin e ja solli atij jetrit gjíton e i tha:
“Mbamë pullarin e jipi një cik bár se t’ gháj përcë u ka t’ vete bëj një mbashát te nj’ katund e nëng bunj ja japi të ngrënt”.
Ai jetri gjíton i tha:
“Ëgh, ëgh t’e vijonj”.
Kur u mbjodh, vate te kij gjítoni e i lipu pullarin:
“Ëm pullarin, se u mbjodha”.
“Pullari” tha “kur vate e ghira atje te katój, te stala nëng ish më, përcë ki vullartur...”
“Ma pullari nëng vullarën”.
“E ru! Atje nëng është... Epuru vullarti”.
Ki, ç’ ki vatur te katundi, ngë duj t’ kridhirën se një pullár vullarën, ma dopu nj’ cik mbajti mënd se ai i ki thën atij se parmëndin e kin ngrën mijt e e buxerarti. Kapirti se kështu duj t’ buxerarën jetri gjíton, përcë i thoj se pullari i ki vullartur. Dopu i tha:
“Ëm pullarin tim, se u t’jap parmëndin tënd!”

Narratore: Benito Pellegrini. *Paese:* Falconara Albanese. *Età:* 14 anni. *Istruzione:* III media. *Genitori:* ambedue albanesi. *Professione:* studente. *Data della registrazione:* 12/08/1969.

HJUGALLI

Një ghër ish një ç'i thojn Hjugalli e rrij me t'jëmën. Allura kish t' vej për drú. E jëma ki dál xhà e i tha të birit, Hjugallit:

“Oj Hjugalli, tirár derën e eja se vemi për drú”.

E jëma i ki thën “tirár derën” inveçe t'i thoj “Mbill derën e eja”. Hjugalli tirarti derën e e vu ndë máj kraghvet e vate apresu të jëmës. Kur e jëma u akorxhír tha:

“Hjugalli, çë bëre?”

“Oj mó, çë bëra? Ti m' thé t' tirarnje derën e u e tirarta”.

“Oj biri im!” tha ajo. E kapirti se i biri ish çót, e ç' mund t'i bën? E u ndistin se të vejn për drú. Hjugalli qellën derën, qellën derën në máj kraghvet. Intantu ish e lodhej. Arrivartin tekú kish t' mirrin drunjët e Hjugalli me t'jëmën pán ca llatrëra se in e kundarin ca solldëra. Këto u trëmbtin e u ghiptin në maj të një arvuri. Hjugalli u ghip me gjith dér... Dopu një cik i tha të jëmës:

“Oj mó, ka t' përmirem...”

“Joo, biri im!” tha e jëma. “Mos përmír, ndëmos akorxhíren ato llatërat e na vrasën!”

“Oj mó, si ka t' binj, nëng mund rrí më?”

“Jo, biri im, mos e bën” tha ajo.

Allura ai pak pak zú e bëri, pak pak...

Këta llatrat thán:

“Ëgh, ëgh, ján e përmírin zogjët...”

Ngë u kin akorxhirtur se Hjugalli ish n' maj arvurit me t'jëmën. Intantu kish derën n' maj kraghvet ai, e e dij ai si rrij, si ndighij... Dopu një cik i tha të jëmës:

“Oj mó, u ka t' dhjés...”

“Jore, biri im! Jo, se ndë ti dhjët, ato akorxhiren e na vrasën, na vrasën!”

“Ma mó, u nëng mund rrí më. Ç'ka t' bënj? Nëng mund rrí më, ka t' dhjés!”

“Jore, biri im, mos e bën, çerkár çë t' resistíriç”.

Hjugalli cik cík... zú e bëri e i véj ndë krie llatrit. Një nga, u akorxhír e tha:

“Ëgh, ëgh, ján e dhjesën zogjët”.

Dopu një cík, ai kish at derën ndë máj kraghvet e nëng mund e mbáj më. Allura tha:

“Oj mó, u nëng mund mbá më derën”.

“Jore, biri im, jo mbà derën atì, se ndëmos i vete atireve e ndë akorxhírin, na vrasën, na bëjn pllecka, na bëjn tape tape...”

Allura ai mbajti derën njetër cík, sa gjith njigherje e la derën e i vate e i ra ndën ndë krie llatërvet. Ata zún e thirrtin:

“Vate rá një táp qiell, vate rá një táp qiell...!” E gjith iktin e vetëm një qëndroi atjè sheghur. Nëng bëri a tiambu t’íkën si bën të tjertë ç’ kin shkuar ndë lum e kin ikur ka jetër án lumit.

Allura Hjugalli me t’jëmën u kallartin ka árvuri e pán atjè gjith ato cíka e shum solldëra. Hjugalli tha:

“Oj mó, i mbjellëm këto solldëra, i mbjellëm e kështu nëng kemi më se t’ vém për drúnj e t’ bím tjert cika, rrím mír kështu me gjith këto solldëra...”

Intantu ki llatër ç’ish sheghur, doli gjith një ghérje me nj’ thík n’ dór... E Hjugalli ç’ kish t’ bën? E u zún e u zún atjè... Hjugalli i rrëmbeu thikën llatrit e i preu një vesh. Kij u vú tue thirur e mori e iku. Hjugalli qëndroi atjè me t’jëmën, mori gjith ato solldëra e i ghëngërtën e i pitën, e na çë rrím këtu, ghám eshtrat.

Narratore: Michele Nesci. *Paese:* Falconara Albanese. *Età:* 18 anni. *Istruzione:* III agraria. *Genitori:* ambedue albanesi. *Professione:* studente. *Data della registrazione:* 26/08/1968.

UJKU E PULLARI

Një dít një búrr vate te fera e bjejtí një pullár. Kur vate mbu shpít i tha të shoqes:

“Bjejtá pullárin e nesmenát” tha “vemi marrëm kríp t’e shitim”.

Ai menátet njëze vet’ te një sallín, bjén kríp e priret. Si priret, ki ka t’ shkon lumin. Pullari si ish i ngarkuar pizante, me shum kríp, si ish e shkon lumin, vate rá ndën ndë mes të lumit. Pullari sá rá, kripa u zú e u jós te ujt të lumit...

Vate mbë shpít e patruni i bëri një skatjatrún me një shkop. Të ditën dit i tha t’ shoqes:

“Nani ka t’ vete e marr spúnj... nesmenát vete marr spúnj”.

Menátnet u ndis, vate te fera e bjejtí spunja e e ngarkoi pullarin mir-mír. Si shkoi te lumi, pullari vate rá njetër ghér e u mbjua me új e nëng mund t’ dil përçë spunjët kin sukartur új e ín më pizánd. Patruni dúj tirárën pullarin, ma pullari nëng mund dil e allura patruni e, shkarkoi e la spunjët atjè e tirarti pullarin atéjza e i tha:

“Nani t’ ndreqi u!”

Mori e e solli ndë mes t’ malit e e la atje pullarin e ai mori e iku. Ndë mbrëmvet, kur ish nát, pullari u trëmb t’ rrij vetëm. U vu nd’ mes t’ dí voje të mbdhej e zú e toji shqejbe te vojet e e bën zjarr.

Atje ish e gjégj një ujk e ju viçinár pullarit.

“Aò, nani jam i vatur!” tha pullari.

“Ma ç’jé e bën? Ç’ do t’ bëç?” i tha ujku.

“U dua t’ vë zjarr gjith dheut...” i rispundír pullari.

“Përçë? Jore, se desën puru t’ bijt tim, ujqít e vegjël çë kam”.

Ujku nguraxharti pullarin t’ véj e rrij me atë e me të bijt e i tha:

“Bëjm një pat. Do viç te kaverna ime se m’ ruan t’ vegjlit?”

“Ëgh, ëgh se vinj!” i tha pullari e vate.

Vate atjè. Ujku i tha t’ bijvet:

“Nani ju solla një mík i rí. Me këtë mund losni ditët e mund bëni atë ç’ doni... U vete shogh t’ gjëj gjë t’ ghá”.

Menátnet njëze, e jëma doli ka gropa e vate se t’ bushkárn gjë t’ gháj. Intantu te gropa pullari ish e lozën me ujqít të vegjël, ma pullari ish sevéru me ata. Duj se kishin t’ rrijn sembre mbrënda... Dopu i mori me shqejbe. Allura ç’ penzartin ata ujqít e vegjël:

“Nani bëjm një shurbes!” thanë.

Tha ai më i vogli:

“U i bunjari te qafa e i zë nj’ micikún, ju i mbani këmbët e e vrasëm”.

Allura kështu bën: gji’ njighéri ván ndë kragh, një i mbaj këmbët e një i mirr kriet e njetër i xú dí a trí micikún te qafa... Pullari zú e ghoji shqejbe, ma i toj gjith ata gjak e diq. Kështu e vrán pullarin. Si erdhi e jëma tha:

“Ju solla mísht!”

“Oj mó, përçë e solle? E kenje risparmjartur. Mund kenje lënë t’ rrij mísht, se nanì sa kemi këtu... Misht e bëm na, përçë e vrám pullarin”.

Narratore: Francesco Candreva. Paese: Falconara Albanese. Età: 16 anni. Istruzione: I Istituto tecnico. Genitori: ambedue albanesi. Professione: studente. Data della registrazione: 09/08/1969.



Foto di scolaresca della comunità di Falconara Albanese agli inizi del '900

GJAKQUMSHTJA

Nji ghér ish i biri i rregjit. Allura nga menát bën supën. Nji menát, si ish e bën supën e ish e prít bukën, jo, ish e bën tap e tap bukën, e preu një gjisht e vate i e rá nji pík gjak te qumshti. Allura i tha t' jatit:

“Oj tát, u ka t' vet' e gjënj një vájz ç' i thón Gjakqumshte”.

Ai tha:

“Ma biri im, ku vete e gjënj?”

“Ka vete e gjënj!”

Allura mori e iku e si kërcejen, inkuntrarti një pjak, ç' ish Zoti Krisht, però kij djál nëng e dij se ish Zoti Krisht. Allura i tha kij pjak:

“Ku je vete, biri im?”

Ai i tha:

“Jam e vete t' gjënj një vájz, ç' i thón Gjakqumshte”.

Allura kij pjak, ç' ish Zoti Krisht, mori e i dha tre nuçile e i tha:

“Teku gjën një fós më i madh me új, çaje një nuçile, allura del një vájz e thót “Uj”, ti thua “Píj”. Ndëmos nëng sósën këta új, ka t' veç t' gjëjç njetër fós më të madhe e dopu çán njetër nuçile...”. Allura kështu bëri kij djál.

E para vat ndë një fós i madh e e gjet këta új, allura e çaj një nuçile, doli kjo vájz e i tha:

“Ujë!”

Ai i tha:

“Píj!”

Però këta új nëng i sosi e bëri e iku, sparirti kjo vájz. Allura i qëndroitin dí nuçile e vat'e kërçè, kërçè, kërçè e vate ndë njetër rrënx i madh; allura çajti kët nuçile e doli njetër ghér kjo vájz. Tha:

“Uj!”

“Píj!” tha kij.

Ma nëng i sosi mëngu, e sparirti njetër ghér. Allura vate te njetër rrënx edhè më i madh ndutu, çajti kët nuçile e dolli kjo vájz njetër ghér. Tha:

“Uj!”

“Píj!” tha kij.

Ujt i sósi e i qëndroi kjo vájz.

Allura kij, i biri i rregjit, e mori e e vú n' maj një árvuri e vate te kasteli se t' i thirrën t' jatit.

Ndën këtij árvuri ish një krua e ndë atë krua shighëj ajo ç' ish ndë máje árvuri, Gjakëqumshtja.

Dopu një cikë, vate një vájz ç'ish e líg e shigh atjè ndë krua e thójn:
“Ma u ç'jam aq e bukur e m' thon se jam e líg!”

Allura Gjakqumshtja, ajo vájz ç'ish atje ndë máje, zú e qeshi. Kjo vajz e líg tha:

“A ti jé?”

Kjo i rakundarti llu fatu si ish atje.

Allura kjo vajz e líg invidjúze, mori një spingull e thoj se ki' një morr ndë báll e e shpoi e i bëri një vër ndë báll e kjo Gjakqumshtja u bë një pllumb e u vú kjo e liga ndë post të sáj, atjè n' arvur.

Kur vate i jati, rregji me t' birin tha:

“E shegh ku ë?”

“E kështu e líg ë?” tha.

“E tát” tha i biri “u kur e lé, ish e bukur”.

Allura dopu e mori e e martoi kët vájz. Dopu ç'e martoi kët vájz e líg, kjo rrij sembre mbë shtrat përcë nëng dúj t' shíghej se ish e líg. Ma kij pëllumb, ç'ish Gjakqumshtja, gjith dít véj te finestra e kësáj ç'ish nanì Prinçipesa, e kjo i ordinarti servitúrve:

“Mirrni atë pëllumb e vritnie, vritnie se dua t'e ghá”.

Servitúrt muërtin e vrán e e ghëngërtin e eshtrat muërtin e i ghojtin te kopshti ndën finestrës. Atjè u rrit një arvur i madh i madh, më i madh se pëllasi i rregjit. Allura kjo Prinçipesa i ordinarti serviturvet se kish t'e prizin kët arvur. Nanì kur in e prizin me topnat, arvuri bëj:

“Qanu qanu, se m' cënoni! Qanu qanu, se m' cënoni!”

Dopu një cík, shkon atej një pják e i tha njerzvet ç' prisjin kët arvur:

“M' i jipni dí skexha se t' çeli zjarrin?”

Ato burra thán:

“Ëgh! Mirrni, mirrni!”

Kjo pják mori skexhat e i vú te ghít atje mbë shpí t' sáj.

Nga dita kjo pják ikën e dopu kur u mbidhij, gjën shpín gjith t' komitartur, trijësën gjith të ndrequr, i bën të ngrënt, përcë skexhat u kin diventárt njetër ghér Gjakqumshte. Ma dopu çë bën të ngrënt, kjo vajza, Gjakqumshtja, vej e sheghej.

Kjo pják, kur mbidhej e shigh shpín t' ndrequr, thoj:

“Ma kush ë? Kush nëng ë?”

Një dít, kjo pjaka e zú tue qeshur, e pá e i tha:

“Ti je?”

“Jam u, jam u, Gjakqumshtja!”

E i tha të gjith llu fatu, gjith ata çë shkoi.

Një dít i biri i rregjit u adunár se me kët pják rrij një vájz e bukur e

allura thirri kët pják bashk me Gjakqumshtjen te pëllasi i tij se t' véj e t' gháj me atë.

Dopu ç' ghëngërtin e pijtin, i biri i rregjit tha:

“Këtu kemi uzánx se dopu çë ghám çëdonjë thot një purrallëz”.

Allura mori e tha ajo vajza ç'i thójn Gjakqumshtja, zú e tha diskursin e sáj: si kij djál e ki lën máj arvurit, si qe bër pëllumb e arvur e përcë rrij me kët pják...

I biri i rregjit, dopu ç' gjegji kët purrallëz kapirti atë ç' tha ajo. Kët vajzën e líg e nxóri jást pëllasit e e vrán... U martua me Gjakqumshtjen e shkuan vjet e vjet báhka-bashkaz.

Narratore: Raffaele Valente. *Paese:* Falconara Albanese. *Età:* 16 anni. *Istruzione:* III media. *Genitori:* ambedue albanesi. *Professione:* studente. *Data della registrazione:* 11/08/1969.



Gruppo di giovani falconaresi riuniti in occasione della festa patronale della Madonna del Buonconsiglio (inizio anni '60 del XX secolo)

ZOTI KRISHT E SHËN PJETRI

Kur Zoti Krisht xhirarnej për katundëra me dhjetedi apostullat, një ghër si ín e kërcëjin udhës e udhës, i mori úja e nëng kín ne búk e ne faregjë të ngrën. Zoti Krisht ahierna i tha:

“Mirrni një gúr për një”.

Apostullat muërtin ka një gúr të madh, vetëm Pjetri mori një voje i vogël. E dopu ç’ muërtin gúrt, zún e kërcietin udhës e udhës. Apostullat të mjér, ç’ kin gúr të mbdhenj në máj kraghët, kërcijin qanu-qanu, vetëm Pjetri véj mír, përçë nëng kish një píz i madh. Dopu arrivartin te një katund t’ e gjetin të bjéjin ca búk, ma nëng ish. Allura Zoti Krisht tha:

“Ju bi benedicjón e gurt bënen búk...”

Kështu bëri e apostullat ç’ kin gura të mbdhenj, pán një kuponje me búk. Pjetri çë ki sjéllur një voje i vogël, mbeti me duër vakant, përçë kish vetëm një thél búk. Kur pá këta, Pjetri i tha Zotit Krisht:

“E u çë ghá?”

Zoti Krisht i përgjegji:

“Ti, vëllau im, përçë solle një gúr i vogël? Të tjért çë sollën gura të mbdhenj, nani kán búk të mbjonen”.

Dopu çë ghëngërtin, zún e kërcietin njetër ghër e Zoti Krisht tha:

“Mirrni njetër ghër një gúr për një”.

Kët ghër Pjetri mori një gúr i madh. Të tjert apostullat muërtin gura të vegël. Zoti Krisht i tha apostullvet:

“Nani doni të qeshni me Pjetrin?”

Kur ghítin te një katund ç’ish pjot me furre çë bëjin búk, pán apostullat e tojtin gurat e ván e bjejtin búk të frisku...

Pjetri, i vrári, ç’ish prapa, e di vetëm ai si solli at gúr i madh, kur pá ato furre çë nxirin búk, tantu ç’u ngacár, nëng desh nemenu të provárën bukën... Apostullat të tjér qeshtin mír mír për Pjetrin.

Narratore: Franco Chillelli. *Paese:* Falconara Albanese. *Età:* 21 anni. *Istruzione:* V elementare. *Genitori:* ambedue albanesi. *Professione:* fattorino telegrafico. *Data della registrazione:* 25/08/1968.

KULEÇËT, NANA, SE T' JAM MBES

Ish një ghër një pják me një mbés. Erdhi Doratali e kjo mbés duëj kuleçët e i tha nanës:

“Nana, erdhi Doratali e gjith bëjn kuleçët e na nëng kemi”.

“Bija ime, si ka t'i binj, se nëng kemi rrush të thát”.

“Nanì vete u e gjënj rrush të thát!”

Vate e gjeti e ja solli nanës e i tha:

“E këtu është rrusht të thát, nana!”

“Bija ime, solle rrusht të thát, ma nëng kemi miell!”.

“Nani vate e gjënj!”

Vate e gjeti e kur ja solli nanës i tha:

“Këtu, nana, është miell!”

“Solle rrusht të thát, solle miell, ma, bija ime, nëng kemi vaj!... Si ka t'i diganisinj pá vaj?”.

“Nani vate e gjënj. Ëm një butij e t' siell vajt!”

Vate e gjeti vajt e ja solli nanës:

“Këtu, nana, vajt!”

“Nanì, bij, nëng kemi diganin!”

Vate e gjeti e ja solli:

“Këtu, nana, digani!”

“E nanì, bija ime, nëng kemi drú!”

“Nani, nana, vate e gjënj!”

Vate ndë malt e gjeti drút e ja solli:

“Këtu, nana, drút!”

“Nanì, bija ime, nëng kemi tripëtin!”

“Nani vate e gjënj!”

Vate e ja solli tripëtin:

“Këtu, nana, tripëtin!”

“Nanì, bija ime, t'i binj kuleçit, uju!”

E u vù e diganisi... Nana diganisën e e mbesa thój:

“Kuleçe, nana, se t'jam mbés!”

Narratore: Franco Chilelli. Paese: Falconara Albanese. Età: 22 anni. Istruzione: V elementare. Genitori: ambedue albanesi. Professione: fattorino telegrafico. Data della registrazione: 10/08/1969.

URSI E DHEJPRA

Një dhejper dolli ka foléja se të gjëj gjë të ngrën. Udhës e udhës, cuparti ursin.

“Ku je e vete”, i tha, “ciciu i im?”

“Vete n’at katund, ç’ shighet atje ndën, se m’ thirrtn se t’ lozi”.

“Mund t’ viny me tij?” i tha dhejpra.

“Eja, eja puru”.

Ván n’at katund ku qen pritur mír. U dhán puru se të ghájn, ma atireve nëng i sosi e kështu ghijtn ndë kuçint e u vún e gjetin të gjëjn më gjë. U akorxhír patrunia e shpís e muartin një shkop e i nxurtin jasht ka katundi. Ato di u trëmtin e iktin pá fare t’ rújn prapa. Kështu tue errur arrivartin ndë njetër katund. Ahierna ursi u vú tue thirrur:

“O ç’úr çë kam! O ç’úr çë kam!”

“Ndë ti ké úr, kam u llu stesu úr” i tha dhejpra, “Ec ndë katund e sll një folé me mjájt se u të priti këtu”.

Ursi vate ndë katund, vodhi folén me mjájt e ja solli dhejprës e i tha:

“Kjo është!”

“Nëng ghám fare mjájt, më mír se e lëm për menát...”

Ursi i tha:

“Ëgh, e lëm”.

U ujtin e u vún tue fjetur. Dopu ca ghér dhejpra u zgjua e u vú tue thirrur.

“Ç’është? Ç’është?”

Ursi u zgjua ka vuçët çë bëri dhejpra e piti:

“Kush të thirrën?”

“Ndë gjitonít parturirti një grua e më thirrtn të bënj një vizit e nëng dij çë t’ sillinj...”

“Silli një cík mjájt” tha ursi.

Dhejpra vajti te foléja me mjájt, ghëngër mír e mír e dopu u mbjodh.

“Ç’ëmër i dhé këti të vogli?” i tha ursi.

“Supërfiçe” i tha dhejpra e u vú tue fjetur njetër ghér.

Natënët pire u zgjua dhejpra për të ditën ghér se kish úr e u vú tue thirrur:

“Ç’është? Ç’është?”

Ursi u zgjua e e pijti:

“Kush të thirri njetër ghér?”

“Ndë katund” rispundirti dhjebra “parturirti njetër grua e më thirrtn se

të vete bënj vizit të voglit e nëng dij çka t' i siell".

"Silli një cík mjájt" i tha ursi.

Dhejpra vate, u ndënd me mjájt e dopu ç' u ki sacjartur, u mbjodh te ursi.

"Ç'ëmër i vure të voglit?" tha ursi.

"Gjimësa" rispundirti dhejpra e u uj e u vú tue fjetur njetër ghér.

Menatënet dhejpra u zgjua për të tretë ghér pse i erdh ndë kocët se kish të gháj të tjért mjájt. U ngrégh e u vú tue thirrur si para:

"Ç'është? ç'është?"

Ursi u zgjua e u vú tue thirrur puru ai i rrabjarm:

"Manaja, kush ë çë t' thirrën adhè?"

"Ndë katund parturirti një grua e më thirrtin se të bënj një vizit të voglit. Çë thua nd' i siell një cík mjájt?"

"Sille puru, sille" i tha ursi "ma mos më zgjò më!"

"Jore, se nëng të zgjonj më, nëng të zgjonj...!"

Ajo, vate te foléja, ghëngri të gjith mjájt e u mbjodh te ursi.

"Ç'ëmër i vure të tretit të vogël?"

"Fundí" rispundirti dhejpra.

Menatënet u dí, ursi ndien úr e i tha dhejprës se të síll mjájt. Dhejpra vate të mirri, ma e gjeti vakánd folén përçë e kish ghëngër të gjith. Kur ursi pá se nëng kish më një grusht mjájt, u vú tue thirrur:

"Çë fin bëri mjajtët?"

"Nëng dij faregjë u, pse më pijën mua?" i tha dhejpra.

"E ghëngre tí!"

"Si mund e thueç? Mos e pé? Nëng qeva u!"

"Qeve tí! Qeve tí ç' e ghëngre!"

"Jore, qeve tí!"

E u zún... Ursi rríj se t' gháj dhejprën, ma ajo i tha:

"Vemi ka ajo an, atje është një orakull e gjegjim kush qe çë ghëngri mjajtët. Dhejpra qasi ursin ka një tajóll çë ki pár para e i tha:

"Xhurár ndë këtë orakull se nëng e ghëngre mjájt!"

Ursi i tha:

"Bëne tí përpara se dopu e bënj u".

Dhejpra ngrejti këmbën e dréjt qanu-qanu e e poxharti te tajólla e tha:

"Nëng ghëngra mjajt e xhurarem ndë máj të këtij orakull çë nëng ghëngra".

Allura ursi ngrejti këmbën pizante e tue folur me vúxh të madh tha:

"Nemeno u ghëngra! E batirti me këmbët maje ghékurvet më fort se

mundin e qëndroi me këmb ndë tajollët”.

Dhejpra, kur pá ursin në tajollët, iku. Tue ikur i tha:

“Eh ursi i im, ti ké kriet të madhe, ma sa është të mbrazët!”

Narratore: Franco Chilelli. *Paese:* Falconara Albanese. *Età:* 21 anni. *Istruzione:* V elementare. *Genitori:* ambedue albanesi. *Professione:* fattorino telegrafico. *Data della registrazione:* 25/08/1968.



Gruppo di giovani falconaresi sul sagrato della chiesa di S. Michele Arcangelo
(fine anni '50 del XX secolo)

NUSJA E FATARME

Nji ghér ish një bér rregjit e dúj t' martonej. Vate udhës- e- udhës e inkuntrarti një pjak.

“Ku jé vete?” i tha pjaku këtij djál.

“Dua t' martoghem, vete gjënj nuse”.

“Shum mír!” i tha pjaku e i dha dí nuçile.

“Çajti te lumi!” i tha.

Kij këtu vate e i çajti te lumi e i doli një kopile e bukur e bukur, ç'ish më e bukra e gji' dheut. Ajo i líp új:

“Ëm új!” tha.

Ish pak új e i tha:

“Nëng kam!”

Ajo kopile allura sparirti, iku. U ki sikartur uji e ajo doli e u shegh. Dopu vate e çajti jetrën nuçile. Vajti e e çajti te di lumëra e i doli njetër ghér kjo kopile e bukur e bukur. I tha:

“Ëm új!”

I dhà e piu új mir-mír. Piu shum új.

“Ndëndonu nani!”

Ajo kopile e bukur, m'e bukura e gji' dheut, allura u vú nd' karrocet e e qelli ndë një katund lluntanu te një pëllas. Psana e là.

“Pritëm këtë! Rrì këtë!” i tha “Se u, vete marr prindët, njerzit e mí, krushqít... Marr karrocën e vinj e të siell”.

Vajti e psana u turrnár t' véj të mirr atë nusen. Vati atjè, 'nveçe të gjën nusen, u gjën njetër grua e líg, shkáv, i thójn një shkavín. Ish e fatarme ajo. Kjo e liga e vrau atë kopilen e bukur, atë të mirën e e ghoji ndë një spinár, ndë ca ferra. Atjè u bijtin dí pllumbëza...

Kur vate dhëndrri me akumpanjamentu t'e mirr, e pá ashtu e i tha:

“Moj ti nusja ime, çë m'u bëre kështu? Kush t' vú këtë tij? Kush të bëri kështu?”

“Mua m' xijti vésa e natës e mua m' xijti dielli i ditës...” tha.

“Uh, kall' i mortit!” tha ai “jenja aq e bukur e u bëre kështu...!?”

“Mú m' xijti dielli e ditës...”

Ma llu stesu e muértën e e vún në karrocët. Kur vún nusen në karrocët, atà dí pëllumbëza vejín apresu e thón tue bër:

Ku-e-kú... Ku-ku-ri-kú

Ku-e-kú... Ku-ku-ri-kú

Shkava në karrocët

e u ndë spinárt...

Ku-e-kú... Ku-ku-ri-kú

Kur arrivartën mbu shpít, atà di pëllumbëza i véjn apresu dhëndrrit, të birit t' rregjit.

Ajo e liga e penzarti e i tha dhëndrrit:

“U dua vrár këta di pëllumbëza!”

Ajo ish e fatarme, ish... Ai, i biri i rregjit, i vrau pëllumbët e i ghëngërti kjo e liga. I qëndroi një cík mish te dhëmbët. Ajo tha:



Scorcio di piazza Scanderbeg

“O, ç’ë këta mish?”

E e mori e e toji nga ballkuni te kopshti i rregjit.

Atjè u bí e u rrit një nerën x e bukur. Onji dí t rritej për trí, veje e madhe... Kur kjo u rrit e u bë e madhe sa pëllasi i rregjit, i tha t’ shoqit kjo gruaja e lig:

“Pré kët nerën x se i mbà zhjén pëllasit!”

Ai bizarti serratúrt, i thirri serraturvet e in e prizin.

Si in e prizin, ajo mbrënda atjè n’ nerën x, tha:

Serratúr çë më serrarën,

Qanu-qanu se m’ stuparën!

Rongarti një skéxh, një cóp n’ mes t’udhës, shkoi një pják e e mori atë skéxh e e qelli mbë shpít. Mbë shpít e kësaj pják kjo skexhe u bë njetër ghér kopile e i kundarti të gji’ storjen e sáj...

Vate kjo pják e stambarti një pëllas para shpís s’ rregjit e bën shum cika t’ mira e ajo i dërgon sembre te i biri i rregjit. Ai i thót:

“Çë cika t’ bukra çë ján këto!”

Ja paguan e i merr. Ajo ikën.

Erdhi një mumend i mír e i tha pjakës:

“Kush i bën këto cika?”

Ajo i rrispundirti e i tha:

“Ndë do t’ marrç, merr!” Ai mori.

Erdh njetër mumend i mír, ajo kopile iku atjè e vate te i biri i rregjit, ç’ ish dhëndrri i sáj e i kundarti si vate, si nëng vate...

E i tha ai psána, dhëndrri, i rrispundirti:

“Nani, si e dò bër këtë?”

U përgjegj ajo e tha:

“E dua bër pjot me ricín, xarrisur qacës e qacës...”

Vëri një frugull, me ndér, në bíth e e djegën...

Ata ghëngëtin e pijtin e mua m’ dhán nj’ ásht.

Narratore: Domenica Buffone. Paese: Falconara Albanese. Età: 75 anni. Istruzione: II elementare. Genitori: ambedue albanesi. Professione: casalinga. Data della registrazione: 11/08/1969.

KOSTANDINI E GARANDINA

Një ghér ish një ëm ç' kish nëndë bij. Nji të dhjetëzën një vashëz ç'i thójn Garandinë.

Erdhtin se t'e mirrin për nuse. E jëma nuk duaj t'ja jip se ish lluntanu, llárgu.

I pari bír, Kostandini tha:

“Ng'ë gjë, nëna ime, se ë llárgu, se vete u e t'e marr, t'e siell u, motrëzën!”.

E ëma e martoi. U martua kjo vashëz e mori për búrr Sarmentarin. Shkoi detin e vate va Lijén.

Dopu rá mortja mixore e i mori kësaj jëmë të nënd bij. Ajo i mbill të gjith shpín e e xijti e mbilli derën me kiç e thrrit të birit:

“Kostandin, bír i im, ngreu e ëmë atë çë m' takse!”

Kostandini u ngre te fosi. Bota ç'ish ndën në sepulltúr ju rivëndár një kál i árt; guri i sepullturës një sél e ërgjënd e virgëza, ç' kish vu kuleta, ju gjënd një vírg e árt...

Ju vú kalit a kavallu e vate rá në dér të motrës. Ngë gjjet të motrën, ma gjjeti të birin e sáj.

“Ku vate mëma júj?” i tha

“Vate te vallijén”

Ai e dërgoj:

“Ec e thúj se erdhi lala ín e vëllai i it, lala Kostandin!”

Eci kij e i tha jëmës:

“Mëma ime, ec se erdhi lala Kostandin!”

Ajo la vallijén e u ndis e erdhi mbu shpít e gjjeti të vëllán:

“Vëllau im, si ka të vij? Ka të vishem nuse o kallogrész?”

“Vishu si t' solla, nuse”.

Si vén udhës e udhës:

“Kostandin, vëllá i im, ata kragh ç'i ké, nëng i ké më, se m'i ké të skopanipur...” (E in të skopanisura vurtét, pá mish, pa faregjë...

Ai i tha:

“Të bënëjin sizit, motra ime, pjughurith kalit... Se ë bota çë shkelën kali...”

Arrivartën te një kísh.

“Oj motra ime, ka t'i falem kësáj konëz...”

Kostandini vate mbu kish e nëng doli më, vate te sepulltura e tij.

Vashëza vate tek e jëma. Busarti mbë dér

“E gháp, mëm, dérën, se erdhi Garandina, e bija jote!”

“Prír, morte mixore, se më more nënd bij, e një të vashëz të dhjetëzën...!”

Ajo tha:

“Ghapëm derën, mëma ime, se jam Garandina, bija jote!”

E ajo ghapu derën. Sa ghapu: puthi njera, puthi jetra. Pjasi e jëma e pjasi e bija... e qëndruën ghareshit.

Narratore: Elena Staffa. Paese: Falconara Albanese. Età: 69 anni. Istruzione: II elementare. Genitori: ambedue albanesi. Professione: casalinga. Data della registrazione: 10/09/1967.



Incontro al Bar di via Buonconsiglio (1964)

TRI MOTRAT E UJKU

Një ghër ish një grua që kish tre vashaz. Kjo grua ish e dis e i tha të bijavet:

“U jam e des e ju qëndroni vetëm. Kur u nëng jam më, ju ecni te cicinjërat, te ungjërat t’aj e bij t’ju bëjn një shpí për një”.

Dopu ç’ tha këta, vdiq.

Këto tre vashaz u vún tue qajtur e ván se t’ gjëjn këto ungjërat. Gjetin të parin, e kij, këtu, i bëri shpín t’ parës vájz ç’i thójn Ndonét.

Të tjerat dí vashaz kërcien adhè se t’ gjëjn të tjért di ungjëra, e gjetin këtë gjírí që bën fallenjamin. E kij, këtu, bëri shpín për të ditën motër.

E treta vájz, më e vogla, dopu ç’ kërceu, pá t’ ungjín që bën llu fabru. Kij këtu i bëri një shpí kësaj ghékuri. Inveçe tjerat motra e kín druri.

Nji mbrëmbe arrivarën ujku e vete te shpia të t’ parës motër e busarti:

“Ndoneta!”

“Kush është?”

“Jam nj’ i mberuëm i tër i lagët. Bij të ghínj!”

“Ik, se ti je ujku!” i tha Ndonéta “E ti do të m’ ghájç mua”.

Ujku shtijti derën, ghíri e ghëngri Ndonetën.

Te e dita mbrëmbe, ujku vate e busarti te shpia e Fillumenës e i tha:

“Fillumena!”

“Kush është?”

“Ghapmë derën! Jam nj’ i mberuëm ç’u zbuër, jam i tër i lagët. Bij të ghínj!”

“Jore” tha ajo “ti jé ujku, erdhe të më ghánje si ghëngre time motër”.

Ujku shtijti derën, ç’ish e bër me drunje, ghíri e ghëngri Fillumenën.

Njetër mbrëmbe, ujku vete te shpia e Diellës:

“Dilúca!”

“Kush ë?” tha ajo

“Jam u... Jam nj’ i mberuëm ç’është e des së timit. Bëj t’ ghínj!”

“Ik” tha ajo “se ti jé ujku e do të më gháç si ghëngre motrat time. Ik, se nëng t’ ’e ghapënj!”.

Ujku shtijti derën, ma datu se dera ish e bër ghékuri, si e tër shpia, ujku çajti shpatullën e kraghut. Vate te ‘nu fabru e bëj t’ i ndreqi shpatullën. Dopu ç’i ja ndreqi, ujku vete te Diella e i thót:

“Gjegj, Diell, u për tij çajta shpatullën, ma të dua mír llu stesu. Ndëgë nes’menát vjen me mua, vemi e mbjedhëm ca qiçëra!”..

Diella rispundirti:
“Ëgh, se vinj. Eja e më merr!”
Ma kjo menátnet njíze, vate e mbjodhi qiqërat e i qellu mbu shpít e i
zijti. Arrivarti ujku e i tha:
“Diell, vjen se vemi për qiqëra!”.



Via XXIV Maggio (anni '80 del XX secolo)

“Jo” tha ajo “nëng vinj, përçë xhà i mbjodha. Shigh korqullat ndën finestrës e fumátën çë del ka çiminía!”

Ujku i tha:

“Nëng i bën gjë, nes'menát vemi për llupíne!”.

“Ëgh!” tha Diella

E llu stesu, Diella, si bëri menátën e pár, u ngregh më njíze e vate mbjodhi llupínet. Kur vate ujku se t'e mírr, i mbësoi korqullat ç'in ndën finestrës. Ujku púr se ish i ngacárm tha:

“Nëng i bën gjë. Nes'menát vjen me mua se vemi e i mbjedhëm ca kunguj!”

“Ëgh! Ëgh!” tha Diella “Se vinj!”

Menátnet Diella, par' se t' dil dielli, vate se t' mbjidh kungujt, ma puru ujku, ç' ki' kapirtur ata ç'i ki' bër Diella, u ngregh puru ai njíze se t' véj e t' e pritën se t' e gháj.

Apena çë Diella pá ujkun, nëng kish çë të bën e u shegh te një kungull i madh. Ujku, kur pá se Diella nëng ish, penzarti se ki' vát mbu shpít e xú e ghëngri kunguj.

Diella, ç' ish sheghur te një kungull, zú e tremarti e tërë, ma ujku, dopu ç' ki' ngrën gjith ata kunguj, kur arrivarti te ai kungull ç' ish Diella, tha:

“Nëng thót më se t' ghá, ma kët kungull ç'është kështu i madh e qelli mbu shpít”.

Mori kungullin e u fermár viçinu shpís të Diellës.

Diella ç'ish mbrënda te kungulli, pá se ki' arrivartur viçinu shpís së sáj, mori ghiku nga kungulli, e ghiri mbu shpít.

Ujku, kur pá kështu, zú e toji kriet te gúrt.

Një mbrëmbe ish e bij zbór e e Diella ish e rrij ngroghët te zjarri, kur gjegji një rrëmúr ke çiminia. Kapirti se ish ujku e mori ca új e e zijti. Intantu ujku kallárej ka çiminija. Cumbarën mbas e kërdirën se vej mbaj vájz, inveçë vate rá te újti të ngroghët e ç'aghjëjna Diella mbeti sembre mír për gjith gjéllën.

Narratore: Michele Nesci. *Paese:* Falconara Albanese. *Età:* 19 anni. *Istruzione:* IV agraria. *Genitori:* ambedue albanesi. *Professione:* studente. *Data della registrazione:* 13/08/1969.

TRI MOTRAT PJAKA

Një ghér in tri motra ç' in të tre pjaka. Njera kish shtatëdhjet vjet, jetra katërzet vjet e jetra katërzetedhjet. Këto motra rrijin te një pëllas. Kjo ç' kish katërzetedhjet vjet, një dít shégh një djál çë shkon ndën te finestra. Allura merr samandilin ç' ish i mbrofumarën e e toji. Ki djál, kur pá samandilin e ndijti profumin, vate te dera te ki pëllas e buzarti. Duolltin të tjerat dí motra e kij djál i tha:

“Mos rri këtu një vájz çë zbóri kët samandil?”

“Ëgh” i thán ato.

Kij djál duj të shigh kët vájz, ma ato motra i thán se nëng mund e shigh. Djali allura, sikome ki' kapirtur se e dúëj mír kët vajzën, vate mbu shpít e i tha t' jëmës se duej të martonej. E jëma i tha:

“O i biri im, rri atento!”

Datu se kij ish bír rregji, ditën dopu vate njetër ghér te pëllasi e i tha atireve motrave se duej të martoni at vájz çë kín, però pár duëj t' e shigh. Ato i than:

“Jore!” se kish t' e shigh vét, kur e ki' martuër.

Allura ai tha se duëj të shigh allmenu një gisht. Ato i thán se ditën dopu mund véj. Këto pjáka ván te e motra e i ndrejtin një gisht kështu bukur, se dukij i një vajzje.

Kur kij djál arrivarti, këto i mbësuan gishtin. Kur ai pá atë gisht, ju inamurár më shum adhè asáj pják e i tha t' motravet se at dít stesu duej t' e martón.

Dopu çë u martuen, ai duëj t' e shigh t' shoqen, ma t' motrat i thán:

“Jore!” se kish t' e shigh vetëm mbë shtrat.

Dopu ç' e ndrejtin motrat mbë shtrat, bëj të ghiri i shoqi. Kur kij e pá se ish pják, e mori e e toji ka finestra. Ndën finestrës ish një dhrí e kështu kjo pják nëng vat e rá mbë shesh.

At mbrëmbe atej shkuan tre fate e kur pán atë ashtu, u vún tue qeshur e dopu ç' qeshtin, e para tha:

“Ti bij t' qeshtim aq, nani u due t' binj një pjiçír: Për mue ti diventárën vajza e më e bukur”.

E dita thót:

“U thom se ti e marton një djál i bukur”.

E treta thót:

“E për mua ti diventárën një zónj për të tër gjellën”

Intantu menatnët i shoqi u zgjua, e kur doli ka finestra e pá atë vájz

kështu e bukur, kërdhirti se ki' zbajartur e vate rëpósh e e mori.

Të motrat, kur pán se ajo ki' diventártur e bukur, pijejtin si ki' qën, e ajo i rispundirti se ki' vát te falenjami... Allura puru këto ván te falenjami se duëjn pjellartur. Falenjami nëng duëj t'i bën, ma dopu e konvinçirtin e ai i pjellarti...

E si një mund t' penzarinj, ato diqtin...

E shoqja e i shoqi, e motra e i biri i rregjit mbetin sembre kundjiendu për të tër gjellën.

Na jemi këtu, ata ján atje.

Narratore: Michele Nesci. *Paese:* Falconara Albanese. *Età:* 19 anni. *Istruzione:* IV agraria. *Genitori:* ambedue albanesi. *Professione:* studente. *Data della registrazione:* 12/08/1969.



Foto di scolaresca con alcune ragazze in costume tradizionale
(inizi anni '40 del XX secolo)

TREDIÇINI

Ish një ghër një búrr e një grua që kín dhjët më dij fëmij. Të tjërt ván e shërbijejtin, vetëm Trediçini qëndroi mbë shpijt. Një ditë vate shkeli grurin e ursit e e pá rregji e i tha:

“Ka veç më bëç një mbashát një ghër në jávt?”

“Ëgh” i tha Trediçini.

Njetër dí rregji i tha:

“Ka t’ veç të më marrç kumbórat t’ ursit”.

Trediçini vate pregárti pullarin e pullari i tha:

“Ec merr ca kásht e ka t’ mbilliç kumborat me kasht”.

In katër ór menát. Trediçini bëri ashtu, ngarkoi pullarin me këmborat e ja solli rregjit.

Shkoi njetër jáv e rregji e dërgoi se t’ bëj njetër mbashat e i tha:

“Ec njetër ghër te ursi. Ec e merr sandonet e ursit!”

Trediçini vate njetër ghër te pullari e e pregarti.

“Ec e merr katër sakuráf” i tha pullari “e ec shpò ndon shtratit t’ ursit”.

Trediçini bëri kështu. Mori ca sakurafa e e shpoi ursin ndon shtratit.

Ursi i tha të shoqes:

“Shoqja ime, ma këtu jáv pjeshta...”

E shoqja i tha:

“Nëng jáv, jo, pjeshta. I shkunda somenát sandonet”.

Dopu një cík, Trediçini vate te e shoqja e ursit, e e shpoi puru atë me sakurafat. E shoqja aghierna tha:

“Ké rraxhun, shoq i im!”

E i muartin sandonet e i ghojtin për dheu.

Trediçini mori sandonet e ja solli rregjit.

Shkoi njetër jáv e rregji e thirri Trediçinin e i tha:

“Ka t’ veç se t’ m’ marrç pullarin e ursit”.

Trediçini vate njetër ghër te pullari e i tha:

“Si ka t’ binj se t’ i marr pullarin ursit?”

Pullari i rripundirti:

“Bënu si një míz e ghíp mbrënd te veshi i pullarit t’ ursit e thueji: Ndo t’ viç me mua?”

Trediçini bëri kështu: u bër si një míz e vat’ e ghipi mbrënda te veshi i pullarit t’ ursit e i tha:

“Ndo të viç me mua?”

Pullari thirri patrunin, ursin:

“Patruni im, ján e më marrën!”
 Ursi vate atje e e pá se ish pullari, e i ghoji vét një frushërát.
 Njetër ghér Trediçini i tha te veshi pullarit t’ursit:
 “Do të viç me mua?”
 Pullari njetër ghér i thirri patrunit e i tha:
 “Patruni im, patruni im, ec se ján e m’ marrën!”
 E njetër ghér ursi vate e i ghóji dí frusherát pullarit. Te e katërta, katër;
 e te e pesa i ghóji pés frushërát...
 Pullari i tha Trediçinit:
 “Vij me tij! Vij me tij!”
 Trediçini e mori pullarin e ursit e e solli te rregji.
 Shkoi njetër jáv e e dërgoi rregji Trediçinin se të mírr ursin.
 “Ursin?!”
 “Ursin, ursin!” i tha rregji.
 Trediçini vate njetër ghér te pullari e e pregarti. Kij i tha bën kështu-
 kështu, e i tregoi...
 Vate psajna te kopshti, tek in gjith ato drunje e bëri shum rumúr. Ursi
 e gjegji e i tha:
 “Ç’ já e bën?”
 Trediçini rispundirti:
 “Jam e binj tavutin për Trediçinin se diq... Ësht i lárt si ti, ësht i pjót si
 ti, e ka t’ provarin ndë çë vete mír”
 Ursi u vú mbrënda te tavuti e Trediçini i vú kuperqin sipri e e pijti
 ursin:
 “Këtu del drít?”
 Ursi i rispundirti:
 “Ëgh!”
 Trediçini i vú një pundín tavutit. Dopu njetër án:
 “Këtu del drít?”
 “Ëgh!”
 I vú njetër pundin tavutit e e mbill të tër tavutin me pundín e ursi
 qëndroi mbrënda. Aghierna Trediçini i tha ursit:
 “U jam Trediçini e t’ mora për çót e nanì t’ sielli te rregji” E e solli
 Njetër jáv adhè i tha rregji Trediçinit:
 “Ka t’ veç e të më marrç te shoqen e ursit”.
 Trediçini zu e qeshi. Dopu ca ghér, vate te e shoqja e ursit e i tha:
 “Do t’ viç te it shoq?”
 “Ëgh!” i rispundirti.
 E kështu e solli te rregji.

Njetër jáv i tha rregji Trediçinit:

“Ka t’ veç e të më marrç vajzën më t’ bukur çë mund të jét”.

Trediçini u vú në maje të pullarit e zú e kërceu se t’ véj të gjën vajzën më të bukur e dheut. Udhës e udhës përpoq një pishk ç’ish mbúll ka újt. E mori e e ghoji mbrënda újt e pishku i tha:



Scorcio del centro di Falconara - Discesa S. Michele - sotto la neve
(inizio anni '90)

“Kur ké bizónj, thirrme!”

Trediçini kërceu adhë e përpoq një fulún miza dheu e u dha ca búk. Mizat e dheut i thán:

“Kur ké bizónj ka na, thirrna!”

Trediçini kërceu udhës e udhës e përpoq një múrr njerz që dújn puru ata vajzën më të bukur të dheut. Atjè afër ish një kastel teku rrij ajo vájz. Kjo vájz kish një vëllá që nëng dúj se të dil ka kasteli. E nana e kësáj vájz i tha të nipit:

“Bën të dajin, se është një djál me një pullár që rri atje e bën ca cika t’bukra”.

Ajo më e bukra e dheut aghierna doli e Trediçini i tha:

“Do të bëç një xhír maje pullarit tim?”

Ajo i tha:

“Ëgh! Ëgh e bënj!”

Pullari bëri tre xhire në rrënx kastelit e gjith një ghéri u vú tue ikur. Arrivarti te rregji e i solli vajzën që ish më e bukra e dheut. Rregji i tha kësaj vájz:

“Do t’ më martoç mua?”

Vajza i tha rregjit:

“Ëgh! Ëgh të martonj, kur Trediçini të ghij mbë zjarr!”

Trediçini i thirri pishkut e atireve mizave të dheut, psajna mori djérst e pullarit e fërkovi ngraghët me ato djérs. Mori një organét e u ghoi mbi zjarr e dopu një cík dóli ka nj’ án zjarrit tue sonartur... Aghierna vajza i tha rregjit:

“Ndë që ti ghije mbë zjarr si Trediçini, u të martonj”.

Rregji u ghoj mbë zjarr e u dogj...

Trediçini martoi vajzën më të bukur të dheut, u bë rregj ka ato dhera e ndë ç’ ë i gjáll adhë rrenjarën.

Na jemi këtu e ata ján atjè.

Narratore: Francesco Candreva. *Paese:* Falconara Albanese. *Età:* 16 anni. *Istruzione:* I classe Istituto Tecnico. *Genitori:* ambedue albanesi. *Professione:* studente. *Data della registrazione:* 10/08/1969.

TRE LLATRA

Një ghér ish një búrr capatúr ç' kish di animaj: një pullár e një dhí, çë kish një kumbór në qáf, ish e siell te një fér t' e shitën. Si ish e véj te ki katund te fera, e pán tre llatra, çë vejin sembre tue vjedhur, e një ka këta tha:

“Doni të shighni se u i vjedh dhín pafare t' adunaret?”

Jetri tha:

“E u i vjedhi pullarin ç'është e vete n' kavalu”.

I treti tha:

“Doni të shighni se u i vjedh cikat ç' ká në kragh?”

I pari llatër vate qanu-qanu apresu burrit e nj' mument ghér i zgjidhi kordën dhís e mori kumborën e ja lidhi te bishti i pullarit. Burri ç'ish e kërcín në máj pullarit, gjegjën këmborën e kërdirën se dhija ish prapa atij.

Dopu një cík údh pá prapa, e pá se dhija nëng ish më e e kin vjedhur. Lipën njerzvet ndë kin pá dhín të tij. E u viçinár nij burri, ç' ish një llatër ka ato tre, e i tha:

“Pé dhín time?”

Ai i tha:

“Ëgh, ëgh e pé e ish e tirarën një búrr atje ndënd”.

Kij burr i tha:

“Mamë kët pullarin tim se u vete shogh ndë gjënj dhín e burrin ç' e vjodhi”.

Kur u lluntanár një cík kij búrr, llatri mori e iku me pullarin. Kërceu e kërceu kij búrr, e nëng pá faregjë. Kur u pruer, e pá se nëng shigh ne pullarin e ne burrin, penzarti se i kin vjedhur puru pullarin.

Të di llatrat ín kundjendu përçë i onji një kish një shurbè' ç' kin vjedhur.

I treti llatër pritën kët búrr te një puc me új e bën skosténa se ish e kján. Kij burr vate te kij ç'ish te puci e i tha:

“U e dij përçë ju kjani. Përçë kini dizgracje sa pata u sot. Ti çë pate?”

Ai llatri i tha:

“Eh, një kashét pjot me ár e me solldëra më rá te kij puc e nëng mund e marr përçë nëng dí t' rrí në máj ujit. Ndë një njerí vaje e mirr kashetën pjot me ár, i ipnja ca solldëra ari...”

Kij tha:

“Vete u e t' e marr, përçë di t' rrí ndë máj ujit”.

“Ëgh, ëgh” i tha kij.

Nxori cikat ç' kish n' kragh e u toj mbrënda te puci.

Kur kij búrr u toj te puci, kij llatri mori cikat t' atij burri e iku. Kij burri capatúr pá te ujt të pucit, e nëng ish faregjë. Dopu u ghip lárt e nëng gjet ne cikat e ne burrin, ç' ish llatri. Dopu kapirti dizgracjen të tij: të veshurat, pullari e dhíja muërtin njetër údh... e kij búrr paç t' véj xhakaronja...!

Narratore: Pietro Zappa. Paese: Falconara Albanese. Età: 13 anni. Istruzione: V elementare. Genitori: ambedue albanesi. Professione: studente. Data della registrazione: 07/08/1969.



Rione Manesato (inizio anni '90 del XX secolo)

SERVITURI I RREGJIT E KALI I FATATUR

Një ghër ish një rregj e kish ca servitúr. Ish një ç'i dukej më kuriozo, i bën t' gjitha cikat që dúej. Po ai rregj i líp sembre ll'impossibile këtij e kij kish t' ja bëni, kish t'arranxharinj të mund t'e sodisfarën rregjin.

Një ditë rregji i lipi se duëj gjetur një vájz, që at vájz si vejin in çerka se e kish zbjérr, nëng mund e gjën më, se e dúej t'e martonj, ajo nëng e dúej... E i lipu këtí serviturit, i tha:

“E, ka t' véç të gjëjsh at vajz, në mos kriet ka t'e pres... Se m' kombinarte shumë, nëng mund të lë më të veç ashtu!”

Allura kij servituri u vú tue kjar e vete tek kali, ç'ish i fatatur, i thot:

“Ai rregji m' lipu at vajz. Ku vete ja marr u? Ku t' ja marr u at vajz nanì atje? Është propriu se ka të më vras! Të më vras! Però ka nëng mund dot t'e ja gjëj atë. Ka të vete? Ku t' ja marr?”

Tha ai kali:

“Mos u preokupár! Çë na rrím e qájm këtu, na vajzën nëng e gjëjm vértét. Përçò merr búk për tij e djáth për mua, se shoghëm në mund e gjëçim, bëjm gjë...!”

Allura kij servituri vete merr djáth e búk, rifornimento për díť e u vún n' kaminu, u ndistin.

E tue vajtur udhës e udhës, ish e ecur në prag të detit e pá një pishk me një gabjan ç'in e zëghçin. Pishku zbír sembre, se ai gabjani ish e e mirr e e gháj. Allura merr kavali e i tha serviturit:

“Gjégj, ec e liberár at pishk këtjetéj ndëmos ai gabjani e ghà atë, e një díť ai mund t' vjénj!”

Kështu e lliberartin. Dopu ç'e lliberartin, pishku tha:

“U jam rregji i pishqvet. Ndë të servirën gjë ndoj díť, m'e thua se shómi ndë mund të ndighi!”

Kij servituri i meraviliartur rrij atésu:

“Ç' bijm na këtu?”

“Liberare!” i tha kavali “Një dit t' servirën! Dopu m' thua. Mos u ngarikár!”

Servituri e lliberarti pishkun. E mori e e qelli n' déť.

U ndis e vatën avanti e gjën nji míz që nëng mund t' qellën një báth.

I tha kavali servituri:

“Merr at báth e qellia viçinu te vëra se ka t'a qellin mbrënda, se ata e marrin cik- cik e e kallon mbrënda!”

“Çë bën e binj? Bën e qelli báth” tha “inveçë të gjëj vajzën?”

“Qelle, mos u ngarikár, një dít mund të servírën!”

Kij kështu bëri, u kallár, mori báthën, e qelli viçinu vërës të mizavet.

Një míz ç’ ish më e madhe atëj i tha:

“U jam rrexhina e mizave. Ndë të servírën gjë ndoj dít, më thua, se shomi ndë mund të ndighi!”

U ndistin e ván papán avanti. Si ván, përpoqën një pëllumbëz ç’ ish e vrit një mushard. Pëllumbi ish e vullarën, vullarën, ma nëng ja shíghte se ç’ ja bëte më...

“Ec e lliberare!” i tha kali

U kallár, muar skupetën e lliberari pëllumbëzin. I tha:

“Ndë të servírën gjë, më thua se u mund të ndighi tij!”

“Va bene...!”

E ringracjarti pëllumbi e këta ván papána udhës-e-udhës.

Inkuntrarín nanì një korv ç’ in e zëghçim me një gjalpër. Korvi ish e zbiri.

“Ec e lliberare at korv!” i tha kavali.

“Ma çë bëjm na këtu?”

“Lliberare, lliberare!” i rëspëndoi kavali.

Servituri allura papán u kallár e u vú e lliberari korvin. Si e lliberari korvi i tha:

“Të ringracjarënj! E më thirr ndë t’ servírën gjë, se shomi ndë çë mund t’ ndighi!”

Kij u vu a kavalu e u ndis e erdhi e xú udhës se kjo vájz gjëndeje te ‘nu kastelu të njëj príncipi. Kij me kalin kish t’ studjarën:

“Ma si vemi e e marrëm na atjè? Se ai ka ‘na difeza. Si vemi e e marrëm na vajzën? Nëng mundim!”

“Si vemi, si nëng vemi. Si mundim, si nëng mundim...” i tha kavali “Vemi!”

“Vemi, vemi!” i rëspëndoi servituri.

Kavali i tha:

“Gjégj, ti vete atje e thue se u bënj ca joka ka ato çë nëng pán adhè. Një kavál inzoma çë bën gjith ata ç’i thua; se ato meravijaren e njeri ka t’ dáj, e çerkarim të mund të dáj vajza. Ndëmos” tha “nëng mund të bëj faregjë. Ma ka të dáj për forca, nëmos...!”

Kështu kij servituri vate atje e kali zú e bëri gjith ato joka e cika të mund t’ qeshin sikè tirarti gjith ll’atencjone të kastelit. Gjith njerzit ç’ in mbrënda dualltin jásh se të shighin ata çë bën e ata çë nëng bën kij kavali e u vún tue qeshur.

Gjithnjëgherje kali u ghoj mbë shesh e nëng proseguirti më të lós.

“Ngreghu!” i tha servituri “Çë bën? Ti bën e skombaririn ato! Nani ç’ vín e bëjn më ato? Nëng shoghin fare më gjë e marrën e ikin...!”

“Jore,” tha kali “Nani thua se më muërtin sísh, e mos ngë më shkon më e bukra vásh ç’është, nëng mund t’ prosequiri, t’ vete avanti t’ binj ata çka të binj ...!”

“Ajo nëng vjen!”

“E ka t’ vinj të më kapërcénj!” tha kavali “E ndëmos më kapërcen, u nëng ngreghem më”.

Servituri ja tha atireve njerzve:

“Njó juve ju parirti t’ divertirçit njëra nani. Nani më muërtin sísh kalin e ai nëng do të bënj më gjë... Përçò, shighni një cík si ka t’ e kombinirim. Ndë çë kavalin nëng e shkon e nëng e kapërcen më e bukra vásh ç’është, ai ngë mund t’ prosequirin e t’ vete avanti t’ bij gjith ato cika... Nëng është një njerí, është një kál...!”

I konvinçirti kij servituri ata njerzit e vajza erdh t’ kapërcín kalin. Kali n’ një mument u ngregh, servituri ju vú apresu a kavalu e mortin e iktin.

Ectën një picikát udhës e udhës.

Vasha tha:

“Ku jé m’ qellën?”

“Njó” tha servituri “te rregji ç’ ká t’ martonj. Ti jé një e taksur atij, përçë u ka të qelli atij, nëmos...!”

“E ku?” tha vasha “më nxore te zjarri e më qellën te piçigrék tue zijtur? Jore, u nëng vinj! U ghijem ka kali...”

“Ma ti jé çot!”

Ti këtej, ti atej e e konvinçirti.

“E allura” tha ajo “par’ se t’ martonj, ka t’ gjën gjith cikat ç’ thom u nanì, ndëmos nëng binjëm faregjë!”

E kështu, mori kjo vajza kullán e zú e shprishi njëqind e një kurál ari. I ghoji gjith ndë dhét... Vate një cikëz më avanti, mori unazën e e ghoji ndë detit si ish e shkon atje afër.

Kështu arrivartën te rregji, e servituri e qelli kët vashën, gjith kundjendu.

“U erdha!” kjo i tha rregjit “Ma par’ se t’ martonj tij, ka t’ më gjëndi njëqind e një kurala, ç’ kish kullana ime, ç’ e shprisha e ç’ e ghoja ndë dhét! Kur më sillni këto cika, aghierna t’ martonj u tij”.

Rregji thirri serviturin e i tha:

“Nëmos nëng vete e e gjën kët qind e një kurala ari, tij u të vras!”

Servituri vate te kali e u vú tue qár.

“Ç’ ké?”

“Joo, kështu e kështu...!” ai i tha “Si mund vete ja gjëj e ja marr u, njëqind e një kurala ari, ç’i shprishi atire dherave kjo? Ku vete ja gjëj u i mëruëmi?”

“Se na rrím e qájm këtu,” tha kavali “është tempo të zbjérr, përçë ndisemi se vemi ka të shoghmi si mund të bím!”

Ván atje udhës e gjetin njëqind kurala e i mëngán një më e vogla. Mori kij e tha:

“Nanì çë bím? At të voglën ku vemi e e gjëjm? Ajo sikuru vate sosi ndën dhé”.

“Thirri mizave! Asáj míz çë ndighe një díf. Lipja, shighe ndë të ndighën t’e gjëjsh”.

Kij e lipi. Doli miza:

“Çë doni ka u?”

“Joo, kështu e kështu...! Zbora një kurál, nanì njëqind i gjeta, ma një nëng mund e gjëj. Mos dinje gjë?”

Kjo miza mori i piti të tjerat:

“Shigh!” tha “Se kij zbori një kural!”

“Ëgh, ëgh!” tha një míz shangát “E kán të voglat time çë ján e brédhen. Ma ë llontanu ka këtu; dughën díf e díf se t’e sjell!”

“Një jáv” i tha kjo miza jetrës “të sosën?”

“Mund t’ jét sosën”.

Miza i tha këtij serviturit:

“Ec e eja fra një jáv këtu, se shoghmi të gjëj kuralin e t’e jap!”

Kur shkoi java, vate te miza e i dha kuralin.

Ja qelli rregjit kij. Rregji aghierna ja qelli vajzës e i tha:

“Shegh kuralin ku është? Shegh? Bën t’a gjeta. Nanì më marton?”

“Jo!” tha “Mos ngë më gjën unazën çë zbora te deti, nëng të martonj fare!”

Kij rregji pamét thirri serviturin:

“Ndëmos nëng vete e gjën unazën, u të vras!”

Kij garxuni, i meruemi, u vú tue qár.

“Ç’ ké?” i tha kali “Përsè qán paméta?”

“Joo, kështu, kështu...! Këtu çë jam e bën e binj? Do t’ më vrás... Të më vrás e soret! Këtu allménu nëng kemi të bëjm më faregjë. E sosim!”

Allura tha kali:

“Vemi, vemi e shoghmi! Vemi e shoghmi te ai pishk çë ndighe, ç’isht rregji i pishqvet. E gharrove? Vemi shomi te ai ndë di gjë”.

Ván atje e thirrtin rregjin e pishqvet:

“Njó” tha “kështu, e kështu... çë më suçedirti. Zbora një unáz se jenja

qellnja një vájz një dít máj kalit me mua. Si ka t' bijm t' mund e gjëjm?"
"Mos u ngarikár?" i tha pishku "Eja menát ndë kët ghér se t'e sjell unazën".

Kij vate të ditën dít e pishku i dha unazën ç'e ki gjet ndë fund të detit. Mori unazën e ja qelli rregjit. Rregji ja qelli vajzës e i tha:

"Nanì më marton?"

"Jo, nanì" tha "Mua m' parirën më shum ai, servituri, se ti, (servituri alla veru ish i biri i rregjit, ma kij nëng e dij). Veç shigh si ka t' bënë: u do t' martonj atë, jo tij. Cikat i gjeti ai, jo se i gjete ti! Ma par' se t'e martonj, dua ka t' m' marrç një cík új Parrajsi e një cík új Pisje, nëmos nëng e martonj".

Rregji vate te servituri njetër ghér e i tha:

"Njó, kjo do një butúj új Parrajsi e një cik új Pisje!"

Kij vate njetër ghér tue qár te kali:

"I meruemi u! Kush vete n' Parrajsi t'e márr ujt?"

"Thirri rregjit të pllumvet" i tha kali "e mënd të vén në Parrajsit të marrën një cík új".

Kij i thirri rregjit të pllumvet:

"Shigh" i tha "në mund t' véjsh në Parrajsit e t' mirrç një cík új?"

"Ëgh, ëgh!" i tha kij. "Një dít më sallvarte e u vete t'e marr ujt".

U ndisi e vate i mori ujt.

"E ata te Pís. Kush vete e merr? Si vete e mirret? Në zjarr kush shkon?"

"E ai korv?" i tha kavali "nëng e mba mend? Merre at korv e thuja se në vete e merr".

Kij i thirri korvit. Korvi erdhi njëze e i tha:

"Ëgh, ëgh! Vete u e t'e marr. Ti m' sallvarte një dít mua e u ka t' sallvari puru tí nanì. Përçë ndë des, des, nëmos menát ndë kët ghér të sjell ujt e t'e jap".

Menatnet korvi ja solli. Kështu kij servituri ja qelli rregjit ujt e Parrajsi puru ujt e Pís e rregji psajna ja qelli vajzës. Ajo tha:

"U ka t' martonj atë, përçë më solli puru ujt e Pís".

"Jo!" tha rregji "Na ka t' bëjm një shurbes: ka t' bijm nu duellu, i pari çë bie mbë shesh, ka të des djegur. Ai çë qëndron, e marton...!"

Kij servituri u vu tue kjár. Tha:

"Jo, u nëng dua ne të martonj e ne t'u des djegur!"

Kali i tha:

"Jore, se për të djegurit, të sallvari u".

"E si m' sallvár ti mua? Se në më vén máj zjarrit, u digjem...!"

"Jo!" tha "Mos u ngarikár. Merr thikën, premë një táp mish te koshuni

i im e u ndaru gjith ngrágh undár, se ata të ndighën të mos digjeç”.

“E jo, digjem u jo ti! Përçë në më servirën më gjë me tij, ku vete, ndë të pres mísht?!”

“Joo, preje! Mos u ngarikár, se arrivarin të mos digjeç”.

Kij mori thikën, preu një táp mish nga koshuni i kalit e u ndár gjith ngrágh. Kij zbori e e u vún máj rogut, máj zjarrit se kish t’e digjin, ma kij nëng u dogj... U bukurua adhè më shum, shum më shum se ata ç’ish më para.

Kjo vasha kur e pá, tha:

“Nëng ë vurtét të jét ai!”

“Jo, jo jam u!” tha “Jam i gjáll, si shegh!”

“Allura, dopu ç’ bëre gjith këto llavure e u gholle puru n’ zjarr e nëng u dogje,” tha rregji “të toket tij të marrtoç kët vashën. Ti merr llokun tim e u marr tëndin!”

Kështu u sosi!

Ata mortin e ghëngërtin e pijtin... E neve një bullikun me eshtra na i ghojin t’i ghájm na.

Narratore: Valter Frangella. Paese: Falconara Albanese. Età: 24 anni. Istruzione: V elementare. Genitori: ambedue albanesi. Professione: lavoratore. Data della registrazione: 07/09/1967.

MË I VOGLI VËLLA, LLU MAGU E E BUKRA E DHEUT

Një ghër ish një búrr ç' kish tre bír e kín një vinje, një vrésht, e te kij vrésht véj nu magu e i vídh rrúsht. Allúra vete i pári vëllá të ruaj vreshtën, vete atje e i zë gjumi. Vete llu magu e i vídh rrúsht. Vete i díti vëllá e i suçedírën llu stesu, i zë gjumi.

Allura vete i treti vëllá, më i vogli. Kij merr i sakurát e e vë ndën kanarócít e kúr i vín gjumi, çë vashjárën kriet, shponij e zgjonij. Tue bër kështu, rjushirti mos të fjëj, e allura pá llu magu si i vídh rusht. Kúr arrivartí llu magu, merr një thík kij e e shpon, e ferirën, e llu magu mori e iku e kij u toj apresu e tue pár gjakun, e pá se kij, llu magu, véj ndën dhét ndë një grút. Allura vete thirrën të vëllezërit e vén të tre atjè. Bën një shurbes me një rumanjele, një kórd e me një këmbór, se të kalláren.

Kalláret i pari vëllá e i vogli tha:

“Kúr ti trëmbë, sonár këmborën, se na të tirarim e të ghipim në máje”.

I vëllai zú e u kallár e e pá se atje ish skúr, u trëmb, e zú e sonarti këmborën për rumanelit. Të vëllezërit aghierna muértin e e ghipin lartaz.

Vete i diti vëllá, sikuru se bën më mír, se arrivarën ndën grutës. Ma zú e u trëmb puru ai. Kur zú e pá ashtu skuru-skuru, u trëmb e sonarti këmborën e të vëllezërit kështu e ghipin. I treti vëllá tha:

“Vete shogh puru u!”

Kallaret ai pa fare të trëmbej përçë dúj t' véj e t' arrivarën teku ish llu magu se t' e rrumbej, t' e márr e t' e vrás. Nget për dheu e zë e ruën ka nj'án e ka njetër se t' mund t' e gjëj. Arrivarën te një kamër e shegh ca dele. Kërcen më një cík e gjën njetër kamër e shegh një derk, dós me kunij. Kur arrivarën te e treta kamër, atje shegh një vájz e bukur e bukur, ç' ish më e bukra e dheut. Kjo vájz zú e i tha se llu magu e ki' vjedhur e e mbáj atje të sheghur, të mbillur. Allura penzartin báshk si kish të bëjn se të mund t' ikin ka atjè.

Kjo vájz bëj t' u shegh kët djál ndënd shtratit e prepararën cikat të gháj allu magu. Kur arrivarti kij, llu magu, zú e durarti e u adunár se kish t' ish njerí mbrënda e tha:

“Ësht njerí këtu mbrënda?”

Kjo vájza i rispundirti e tha:

“Jo, kush mund t' vin këtu?! Nëng mund t' jét!”

Merr ai e thót:

“Ë njerí këtu, ë!”

“Jore, se nëng ë, nëng ë!”

Ajo e konvinçirti këtë se nëng ish fare njeri e i dha t’ gháj. Ai bëni e ghëngri. Dopu ç’ ghëngri vájza i tha:

“Lozëm një cík me palën?”

Llu magu i rispondirti:

“Jo. Ç’ jemi të vegjël?”

Ma dopu loztin. Si loztin, vajza ghoji palën ndën shtratit tek u ish djali e i tha allu magu t’ vėj t’e mirr palën. Llu magu parna ki thën jore, ma dopu vashjár se t’ vėj t’e mirr, e kështu, djali, ç’ish ndën shtratit, merr e e vret.

Allura prepararin se marrën e ikin, se t’ ghipin lartaz. Djali lidhi pár një dele e sonarti këmborën. Të vëllezërit tirartin pár delen e dopu ghipitën vajzën. Ma i vëllai i vogël e dij se të vëllezërit, shighin atë vájz, e dopu më nëng tirarin atë në máj, e kështu i tha vajzës ai:

“Ka t’ më pritç një vít, një muěj e një dít, nëmos u nëng vinj, ti martóu!”.



Casa tradizionale del centro storico restaurata dall'Amministrazione Comunale verso la fine degli anni '90 del XX secolo

E i dha një unáz. Kështu bën e u njit.

Dopu ç' tirartin vajzën, të vëllezërit ghojtën njetër ghër kordën, ma inveçe t' lidhij ai, lidhi një gúr e kështu pá se guri kur e kin grëjtur e lán gjithnjëghérje, përçë kërdirin se ish i vëllai e dúj t'e vrizin.

Kështu ai qëndroi vetëm e zú e xhirjarti për grutën se t' mund t' gjën një údh se të dil. Dopu çë xhirjarti e skavarti, doli ndot détit, ma xhà kish shkúr një vít e një muëj e kjo ish e llurtimja dí.

Kij, si doli, pijti një t' katundit e i lipu ç'ish e bënej. Kij i tha se kish t' martonej një vájz ç'ish më e bukura e dheut, se véj krushq, se... e inzoma i rakundarti gjith llu fatu ç' kish suçedirt.

Allura djali gjithnjëghérje vate teku kish t' martonej kojo vájz, e gjegji atij se onjuno kish t' thónj një purralléz. Purrallëza ish: se një ghër kjo vájz kish një kiç ari e një kiç ghekuri, dopu i kish zbjérr e kur i gjeti, mund t' mírr vét një... E allura piti gjithve:

“Cilën kish t' mírr? Kiçin e arit o kiçin e ghekurit?”

Gjith thán:

“Kiçin e arit!”

Vét djali tha:

“Kiçin e ghékurit!”

Vajza aghierna e njoghu e tha:

“Kij ë dhëndrri im! Kij ë dhëndrri im!”

E kështu u martuërtin e gjelluën shum vjet bášhk kundjendu. Na jemi këtu, ata ján atje.

Narratore: Michele Nesci. Paese: Falconara Albanese. Età: 18 anni. Istruzione: III agraria. Genitori: ambedue albanesi. Professione: studente. Data della registrazione: 20/08/1968.

KOSTANDINI E GARENDINA

Ish një jëm e kish nënd bij e të dhjetëtën një vash. Rá mortja mixore e i mori të tetët bij. Vashëz i erdhi një matrimon, ma ish keq lluntanu. Kostandini i tha të jëmës:

“Mëma ime, e martojm këtë Garandinën?”

“O bír, ndë líp, kush vete m’e merr? E ndë gáz, kush vete m’e merr?”

“Vete u, mëma ime, vete u e t’e marr Garandinën!”

“Garandina, motra ime, jam këtë matrimon, se ki matrimon është i mír”.

“E ma bír e biri im, kush vete m’e merr?” priret e i tha ajo e merueme kështu.

U përgjegj ai:

“Vete u, mëm, e t’e marr. Vete u!”

Rá mortja mixore e m’i mori puru Kostandinin. Ai ish ll’ultimi bír, ish i nënd bír. E ajo, e jëma, zú e thrrit prá dopu:

“Kostandin, biri im, kush vete m’e merr Garandinën?”

Ai e ndiën të jëmën në verr, dopu ghapi tavutin e u ndis udhës e udhës e vate e mori të motrën. Ajo ish e luën në një valle. Kij vati te bijt e i tha:

“Ku ë mëma juej, mëma Garandina?”

“Ësht e luen mbë një valle” tha ajo.

“Ecni e thërritni! Thuej se erdhi lala Kostandini”

Ata ván e thirrtin:

“Mëm, e mëma ime, eja se erdhi lala Kostandini!”

Vati kjo mbë shpí e gjeti Kostandinin. U përshtua, u abraçár e tue qár i tha:

“Kostandin, vëllath i jim, ç’ suçedirti kështu, çë shurtoi?”

“Eja, se mëma të do!”

Prá u selue e u ngarkue e u ndistin e ván përpara udhës se t’ véjn tek e jëma.

“Kostandin, vëllath i jim, kraghëvet... Nëng i ké ti si i kenje para, ké vét eshtrat...!”

“Ësht pjughuri, motra jime, është pjughuri... Ma vemi te ato dhéra, te jëma se na prit”.

E “vëllath i jim” e “është pjughuri, është pjughuri” e kështu e këtjè... njera ç’arrivartín avanti një kísh. I tha kij së motrës:

“Garandín, motra ime, ndisu ti e ec te mëma, se u ka t’ véti te kjo kën se ka t’ sallutari Zotin Krisht”.

Ai ghiri atjè, u buer, vate u sepelirti teku kish të véj t’ sepelirij e ajo e

motra vate perpara te shpija të jëmës.

“Mëm e ime, mëm e ime, ghapëm derën se jam Garandina! Garandina, bija jote!”

“Ik morte mixore, se më more të nënd bij, naní do t’ më merrç puru mue!”

“Mëme, mëma ime, jam Garandina! Ghap derën!”

Një ghapu derën... puthi njera e puthi jetra, pjasi njera e pjasi jetra...

Narratore: Ildegonda Manes, Musacchio. *Paese:* Falconara Albanese. *Età:* 81 anni. *Istruzione:* elementare. *Genitori:* ambedue albanesi. *Professione:* casalinga. *Data della registrazione:* 29/08/1967.



Scorcio panoramico dei rioni Cortina e Manesato

TRI MOTRAT, NJË VËLLATH E E BIJA E RREGJIT

Një ghér ish një rregj e kish tre bija fëmra. Njerës i thójn Lina, njetërs i thójn Fineta e jetrës i thójn Nora. Fatu sta se ish e diq i jati i meruëm e i thirri të birit, se kish një bír mashkull e i tha:

“Biri jim, u t’afidarij Ila sorte të tí të motrave. Për tre menáte ka të daliç ka ballkuni e atë çë shegh e t’ prezentaret më pár, ka të japç për shoq onji motre”.

Ai pásht t’ gjegjën, është e obedirën e dopu një jáv nghapu derën e doli n’ maje ballkunit para se t’ bëjn dí, para se t’ këndon gjeli, e nga lluntanu gjegjën një strúsh kumborje. Ruen për së lluntanu kështu e shegh një kavallár, një me animaj çë véj e i pashirën, kullotën e i thirri:

“Eja, eja ghipu këtu! Ghipu këtu!”

“Preñcipe, çka t’ binj?”

“Ghipu këtu!”

Kij mori dí mij pjastër më dór për páj e i thirri të motrës, Finetës:

“Fineta, gjegjmë. Këta është paja, kij është it shoq! E meruëmja Finét!”
tha dopu. U abraçartin e ván.

T’ ditën dí, par’ ç’ ngreghnje njetër ghér dielli doli n’ máj ballkunit e së llargu shegh një porkár, ç’ riej thit e i thirri:

“Eja këtu! Eja, ghipu këtu!”

“E çka të binj?”

“Ghipu këtu!”

Mori dí mij pjastra e i thirri Linës:

“Lín, motra ime, gjegjmë! Këta është paja, kij ë it shoq! E meruëmja Lín, ka t’ marrç një porkár!” e mori e iku.

Të tretën dí, doli njetër ghér ka ballkuni, loxhata, e riejti. Lluntanu lluntanu shégh një kish e te ai kish ish një bekamort e i thirri:

“Eja, eja këtu! Ghipu këtu!”

Kij erdhi e u ghip. I thirri Norës:

“Nór, motra ime, këta ján dí mij pjastër e ki është it shoq! E meruëmja Nór!” e vate.

Vate allura kij udhës e udhës, nghapu-nghapu... ca ghér gjegjën një, çë shtjen pén banda e thój:

“Eja dí, eja dí...! Ec te fortuna jote! Ec te fortuna jote te gjëç páq e mír! Është një rregj ç’ ka një bij t’ vetme e kush vinçirën trí prove, merr t’ bijën për shoqe... kush vinçirën trí prove, merr t’ bijën për shoqe!”

Kij këtu:

“Çka t’ binj? Nisem!”

Mori një kal, mori të ngrënën, mori solldere e u ndis te fortuna e tij. Ecën e ecën, ecën e ecën udhës, nghapu-nghapu, të parën mbrëmbe u gjën ndë një dushqé e madhe e te dushqéja shegh një dritëz e vogël e vogël, vaqëlende-vaqëlende e ai tue ndisur tue ndisur njësh asáj drít, arrivarti te dera. Atjè te dera gjën të shojin e Finetës si ish e këndon... e shoqja në dór... Kij i këndon Finetës se ish e bukur, se ish bij rregjit, se ish një xhoje... e këndon e abraçarsën, e këndon e abraçarsën...

Ai i meruëm, llu principe, gjegji gjith, kjajti një cík e dopu u ngregh e vati e ghapu derën e u ghip mbrënda.

Motra kur e pá i tha:

“O, vllau i im! Vllau i im, u kam gharé” tha “U jam kundend. E ti?”

“Ee...!” vasharti sít e ndënji “Në jé kundjendu... Në ké gharé ti, çë ké një kavallár” tha “mund t’ kém u gharé, mund t’ jém u felíçe...”.

Ghëngërtin, pitin, lostin e u divertirtin e menatnët ai u ndis para se të dighij dielli, para se të këndon gjeli. U ndis, ma e motra, e meruëme, nëng kish ç’i jip. Tha:

“Nëng kem çë t’jip, vëllath i jim!”

Mori një kështënj, e laghu me lot e ja dha të vëllát. Ai e mori e e vú te karcela e zú e eci njetër ghér.

Ec e ec, udhës e udhës, e çë bëri? U gjënd ndë një dushqé e madhe e shegh një drít e vogël. Rraghu e rraghu dréq asáj dritëz, arrivarën te një shpí e gjegjën një çë këndon. Ish porkári e kish të shoqen në dór e këndon, këndon, këndon e e motra ish e qeshën... Kish një të vogëlth më dór ajo e ish e piq një kunill. I shoqi këndon e bën caríqe, e ajo qeshën e piq kunillin. I vëllau gjegjën e kján... Finalmente ghapu derën e vate te e motra:

“Motra ime, Lina!”

“Oh, vëllau i im, ti jé? U jam kundjend! E ti?”

Ai shtërngoi kraghët e nëng foli fare.

“Aa vëllath i im, nanì ç’erdhe e bëjm të ghám kët kunill e pím e lozëm...”.

“Nërtò triesën” i tha i shoqi “se ka të ghám këtu!”

Zún e festexharën t’ kunatin. Ghëngërtën, pitin, lostin e menatnët pra njetër ghér, para se të këndon gjeli, u ndis. Para se t’u ndisij, e motra nëng kish ç’i jap, ma mori një árr, e laghu me lot e ja dha të vëllát:

“Nëng kam çë t’jap, vëllath i jim, ma mirr kët árr!”

Kij e mori e e vú te karcela e vate, vate, vate, u gjen te një údh e gját e

deserta. Intantu u bë nát, u err. Llargazi shegh një kish e pásh t' ghij atje. Lidhi kalin ndë një lok atje e ai ghiri mbrënda e shegh ndë skuratori u një vájz që kallarej e ghipij ka sëmbëturat... Vate u qas e e rujtí. Ish e motra, Nora. I shoqi, bekamorti, zgavarën e nxír eshtrat e e motra, e meruëme, i ndighën t'i karjarin e i shtin te osári. Ai shërtoi prá e i tha:

“Nora, Nora, më njegh?!”

“Ëgh, vëllau i im! Ti jé? E si gjënde këtu?”

U abraçartin e u vún e kjahtin të di. Ai i thirri të shoqit:

“Dhëndërr, eja!”

“Ësht e shkulën eshtrat e t' dekunvet” tha ajo.

Kur erdhi kij bekamorti, ç'ish e nxír eshtrat, tha:

“Mír se vjen, Prinçipe! A do t' viç t' ghác me né?”

Kur u vún te trieza e ján e ghán, ai bekamorti u vú e këndoi e tha:

“Të ghëngët e t' pít është një fjaj, të rriç në páq me të shoqen e me të bijt, këta është gjella, të tjért cika nëng ján gjë...” sosi ai.

Ghëngërtin e pijti e fjëjtën, prá menát, para se të bëjn dí, u ndis. Ma para se t'u ndisij, e motra nëng kish ç' t'i jap. Mori një çerín, e laghu me lot e ja dha:

“Vëllau i im, nëng kam që t'jap, ma mirr kët çerín, se mund t' servirën!”

Kij e mori e vú te karçela e u ndis.

Kërçè, kërçè, arrivarti në Portugallo. Arrivarti atje e vate te rregji. I tha:

“Maestà, dua tèt bij!”

Ai vaçillarti e tha:

“Dopu tre prove, ti e ké time bij, nëmos nëng mund t'e jap. Ti e merr time bij, kur të vinçiriç këto tri cíka!”

E qelli këtë te një kamër e madhe e madhe. Kjo kamër ish pjot me krevele, me bukë, e i tha:

“Kur ti ndë nj'ór më ghà gjith këta búk, ké time bij për shoqe, nëmos...!”

Ai e mbilli atje e mori e iku. Kij, i meruëm, zú e ghëngri. Ghëngri një, dí, trí kravele e dopu nëng ja bëri më.

“E që bënj nanì?” tha.

I erdh mbë trú se kish një kështënj mbë karçele, që ja ki' dhen e motra e madhe e tha:

“Shomi. Nanì ghá kët kështënj, e shomi ndë më ghapën pititin”.

Kur çajti kështënjën e e ghëngri, ván mizat dheu e ghëngtin gjith kravelet bukje. Kur u sos gjith bukët, vate te rregji e i tha:

“Maestà, u ghëngra gjith bukët e ëmni tit bij!”

Ai tha:

“Kur t’ vinçiriç tjetrën çë të thom nanì, t’a jap!”.

E mori e e qelli ndë njetër kamër pjot me új, vaske-vaske me új. I tha:

“Kur ti te një dí pi këta új, aghierna ti ké time bí për shoqe. Nëmos, të pres kriet!”

Ai, i meruëm, ndenja, ndënja, ndënja, pijti fino kur nëng ja bëri më, ma nëng mund e sosi gjith ujt. I erdh në kriet arra, ç’ja ki’ dhen e motra, Fineta. Çajti arrën e duelltin ca kunij, dirqi e e pijtin gjith újt. Allura vate te rregji e i tha:

“Maestà, e pijta të gjith újt. Nanì m’a jep tit bij?”

“T’a jap time bij, ma kur t’ vinçiriç njetër próv!”

E e qelli tek një kamër, një kamër e bukur e bukur. Mbrënda te një shtrat ish një kopile e bukur me dhjetegjasht vjet. Rregji i tha:

“Ti marton këtë, però rrì aténtu! Kur t’ leghet një bír mjeznát e t’ thirrën “tát”, aghierna ti merr time bij për shoqe”.

Ai, i meruëm, penzarti:

“Si mund t’ leghënj ashtu? Si leghëj? Ku mund t’ leghëj?”

Rregji intantu e mbilli mbrënda e ai ndënj, ndënj e ndënj e bëri fórc e kurraxh e vate u vù, u uj pur’ e fjëj. Gjithnjëghërje ka mjeznata i shughet linari. Zjarr nëng kish, fosfër nëng kish, qirinj nëng kish...

“E çka t’a bënëj?”

I erdhi ndë kriet çerini ç’ja ki’ dhënur e motra më e vogël, Nora. Çelën çerinin e vë zjarr linarit e gjithnëghërje i leu ka mjeznata një fëmij i vogël e i thrrít:

“Tà’!”

Ki gjith kundjendu, zú e losi me këtë fëmij tue qeshur, tue... Ma ki ish një bír i dekur ai... Jo? Mos si leghet? Allura kij u ndis e vate te rregji e i tha:

“Maestà, eja shigh çë kjè!”

Rregji vate e pá se kij vinçirti te gjitha cikat e provat e i dha të bíjn.

U martua me t’ bíjn të rregjit e bënë një fést e bukur me zonja e zotëra, me të ngrën: mish, búk e vér, me dulçera e fritulla e gjith cikamík, gjith të mira të Krishtit...

Mua, të meruemës, më dhán një frizele e fórc, vajta se t’a çánj me një mucikún, e m’u çajtin t’ gjith dhëmbët...

Prá u n’ késh si binj... Kál nëng kishin, nëng kishin faregjë, e m’ dhán një ghadhúr, një gadhúr me dí këmb të para vriti e ato prapa kashtje... Një i vogël tóji një gúr e ja xú këmbët të para e u çajtin... Këmbvet prapa m’i vún një fosfër, m’i çeltin me zjarr e m’u dogjtin...!

Udha është e madhe, fjeta është e vogël,
Thuani ju tënden, se u timen e sosa!

Narratore: Ildegonda Manes, Musacchio. *Paese:* Falconara Albanese. *Età:* 81 anni.
Istruzione: elementare. *Genitori:* ambedue albanesi. *Professione:* casalinga.
Data della registrazione: 11/09/1967.



Panorama di Falconara Albanese

STORIA E FALLKUNARËS

Kur erdhtin arbreshërat ndë Fallkunárt ka ll'Allbania dopu disfatës të Skanderbekut, ata tue ecur tue ecur tue navigartur erdhtin e zbarkuën ndë Ghórë ndën Fallkunarës afër detit, te kampi. Këta ish proprietà të Markezës të Rëndes. Ajo i tha atireve:

“Ecni, shkoni lumin të Ghavjanit. Ecni, stisni, shqepni dhërat, rëmoni...”.

Allura këta shkuëtin e ishin shtat vëllezër. Kjo e jëma e t' gjithve këtëre fëmijve ç'ishin e shërbejin, tue bër ruëjti detin. Ruëjti detin e tha:

“Ooo!” E i thirri së rés:

Roza Stania, ime ré.

E kukumelja, ime báj,

Ndisij, se na xuri ghéra,

Se doli qeni e t' davorít,

Se erdhi Qeni Turk,

Qeni Turk mund na zër.



Scorcio di Via P. Mancini (inizio anni '90 del XX secolo)

E zún e iktin e erdhtin ndën Fallkunarës ndë Shën Pjetri. Tue ecur, tue ecur, zún e shërbiën, tue prér dushqén e arrivartën njera Munisát. Atje nëng dukej deti e stistin shpín, vënë puru kishën ç’ish e intitullatur Shëjt Atanazit, ç’isht një Shëjt arbëresh, e aghierna u vún e mbetën atjè. Ishin shtat vëllezër këta e ndejtin këtu ata e bën shtat kazata ç’ján: Manes, Tocchi, Candreva, Musacchio, Scura, Gliosci, e Staffa. Një nga këta shtat vëllezër ish prift ritit arbëresh. Kij prifti bën gjith shoshet në kisht. Dopu bën kishën e shën Mëris Brukunsijit, çë nani u gremís e Shën Mërin e muërtin e e suelltin te kisha e madhe, ç’është sot kisha e Shëjt Mikellit, kisha e parokjes.

Këta vëllezërit tjerë ín capatúr e rëmonin dherat, stisnin e bëjin shërbise. Bën puru mullirin, mbuëlltin arburë: pjeshka, molla, dardha, qërshija, kumbulla, dríjt e të tjera cík... Këto grát bëjin shërbise ka shpijat: bëjin búkë të grínj, búk të grurit, búk melit; zijshin fasulet, bathë e axhirshin pjeqt...

Tue shkuër mot erdhtin të tjerë arbëresh nga Albania. Nani ján di mij abitanti. Më se një mij e treqind fjasën si na, arbërisht. Já n njëqind a San Lluçido, njëqind a Kosenxa, diqind a Roma, diqind ndë Merik e... jan gjika... e u i dua mir t’ gjith e thëm:

“Oj Zoti Krisht, bekona me një gisht!”

Narratore: Ildegonda Manes, Musacchio. *Paese:* Falconara Albanese. *Età:* 82 anni. *Istruzione:* elementare. *Genitori:* ambedue albanesi. *Professione:* casalinga. *Data della registrazione:* 25/08/1968.

LLATRI E KALI

Një ghér një burri i kin vjedhur kalin. Kij búrr ditën karjarën bár e çë kur i kin vjedhur kalin, nëng mund të shurbín më e vate te një fér të bjén njetër kál. Pá te féra se ndë nj' án ín trí kalëra e kij njoghu të tijin. U viçinár, mori kalin të tij, ç'ja kin vjedhur e thirri:

“Kij kál është imi! M'a kini vjedhur trí nát përpára”.

Ai ç'ish e shitën, ç'ish llatri, i tha:

“Jo, nëng ë vurtét, përcë e kenja bjér trí vít më párn”.

Mori kij búrr llanetën të tij e pushtroi kriet të kalit e i tha atij ç'ja ki' vjedhur, llatri:

“Kij kál është guerrç ka një sí!” E i pijti

“Ka cili sí është guerrç?”

Ai rrispondirti:

“Ka siu i shtrëmbur”.

“Jore,” tha kij búrr “përcë nëng shegh ka siu i dréqt...”.

“Ëgh, egh” tha llatri “u zbajarta”.

Allura kij búrr tha:

“Gjegjni, njërz, se kij thót një buxhí, përcë kali shegh ka të di sí e ng' është guerrç”.

Llatri, kur gjegji kështu, zú e iku, ma sosi te kraghët te guardjet ç'e suelltin ndë karçerit, ku pá diellin në kuadrét.

Narratore: Benito Pellegrini. Paese: Falconara Albanese. Età: 14 anni. Istruzione: III media. Genitori: ambedue albanesi. Professione: studente. Data della registrazione: 12/08/1969.

GRUËJA PARABULLARE

Një pjak, si ish rrëmon dheun të tij, gjeti një kashét me solldëra ari. Mori kët kashét e e qelli mbu shpí e i tha të shoqes:

“Rú, çë gjeta te dheu jón! Zoti Krisht na i dërgoi”.

Dopu kij pjak i tha:

“Teku mund e sheghim?”

Gruëja i tha:

“T’ e sheghim ndën astrukut”.

E ai pjak kështu bëri: e sheghu ndën astrukut, ma kur e shoqja doli të mírr një cík új te puci, e si ajo fjít shum, ish parabullare, lavjúz, mbrëmbvet katundi e dij se i shoqi i sáj ki’ gjetur një kashét me solldëra ari. Pjaku, kur diti këta, mori kashétën, ç’ish ndën astrukut, e e sheghu te ca grúr. Kur u mbjodh e shoqja, kij pjak i tha:

“Menát vemi ndë mált t’ marrëm píshq, thughet se këto díf ján shum...”

E shoqja tha:

“Ndë mált nëng ján píshq”.

Pjaku i rispundirti:

“Dopu shegh”.

Menátnet u ngre pjaku, vú mbë kaçele ca pishq e dopu vate te një çë bën búk e bjejtí ca karvele e dopu mori një jepur e e vrau. Dërtoi pishqit me fukaca ndë shum loke, mori jepurin e e lidhi me një lác e e toji te ndë lum... U pruër mbë shpí e ghëngri me të shoqen.

“Vemi në mal?” i tha të shoqes.

“Ëgh, vemi!”

Ván në mal. Dopu çë ván ndë mal e kërcietin një cík, gruëja gjeti për dheu ca pishq. Më atejza njetër pishk e dopu njetër edhè... Gharéshit u vú tue thirrur të shoqit e i mbjodhi e i vú të gjith në një panáre. Arrivarti kështu ndën një dardhje, çë te degat ín vjérr ca fukaca.

“Ruj” tha gruëja “fukacat mbáj dardhës!”

“Nëng ësht faregjë” i tha i shoqi “Rán fukacat ka qielli e qëndruan vjérr te degat”.

Gruëja mbjodhi ndopà. Tue ecur versu katundi, shkuan afër njëj lumi:

“Prit një cík” tha i shoqi “somenat vura një qák mbrënda nd’új, dua të shogh ndë zura gjë. Tirarti qakun e gjeti lidhur një jepur...”

E shoqja u meravijár të gjën një jepur të lidhur mbrënda nd’új. I shoqi tha:

“Nëng e dinje se jepurat rrín mbrënda nd’új si mít?”

“Nëng e dinja fare”, tha e shoqja.

Ván mbu shpít e e shoqja u vú e ziëjti gjith ato të ngrën të mira.

Një pár dít dopu, kij burri tue folur me gjithót, zú se gjith katundi diji teku kin sheghur kashetën me ár. Nëng shkoi një jáv, e ai kje thirrur t’ véj te kasteli i rregjit.

“Ësht vurtét” tha rregji “se gjete një kashét me ár?”

“Jore” tha burri.

“Ma jot shoqe më tha gjith”.

“Ime shoqe nëng dij ata çë thót, ë çót”.

E shoqja, ç’ish ndánt tha:

“Ësht vurtét, është vurtét, rregji im! Im shoq gjeti një kashét me ár e e suterrarti ndën astrakut”.

“Kur?” tha rregji.

“Mbrëmbvet para se t’ véjm ndë mált të gjëjm pishqit”.

“Çë thua ti?”

“Ëgh, ëgh, kje at dít kúr ván e rán karvelet ka qielli e na mbjotthim nj’ panáre pishq, e im shoq rrumbeu në lum një jepur të bukur...”

Rregji kapirti se kjo grua ish çót, ma megjith këta kumbëndarti serviturvet të tij t’ skalárin ndën astrakut të këtij burri, ma nëng gjén faregjë atje ndën. Kështu kij búrr sallvarti kashetën me ari, ç’e gjeti te dheu i tij.

Narratore: Benito Pellegrini. Paese: Falconara Albanese. Età: 14 anni. Istruzione: III media. Genitori: ambedue albanesi. Professione: studente. Data della registrazione: 11/08/1969.

DHEJPRA E KORVI

Një ghér ish një korv. Xhirárni katundin ndë çë të gjëj gjë t' ghánj. Pá te një ballkun se ish një djath e nëng ish mosnjerí atejth. U kallár posh e e muar djathin. Dopu ç'e muar, vullarti te një lis e u ul te kurinjeli. Atje arrivarti dhejpra ç' vate ndon atí lisit e tha:

“Rú sa korv i bukur! I ká pendar t' ërgjënda e picillunin t'árt, ma nëng di të këndon...”

“Korvi, sa gjegji kështu, u vú e këndoi e djathi i rá pirpósh nga picilluni”.

Dhejpra ghapu gojën, ghëngri djathin e i tha korvit:

“E pé e nëng e shegh më!”

Narratore: Vinicio Pellegrini. *Paese:* Falconara Albanese. *Età:* 8 anni. *Istruzione:* II elementare. *Genitori:* ambedue albanesi. *Professione:* studente. *Data della registrazione:* 08/09/1967.



Scorcio del rione Manesato

ÇEKU, SURDI E GUERÇI

Te një qác një ghér in tre njerz. Njeri ish çek, jetri súrd e jetri ish guerç.

Çeku tha:

“Rú, arupllani, sa i madh është!”

Surdi tha:

“Aa çë rëmúr ç’ bën!”

Guerçi tha:

“Vemi t’e ngasm!”

Narratore: Alberto Gnisci. Paese: Falconara Albanese. Età: 9 anni. Istruzione: III elementare. Genitori: ambedue albanesi. Professione: studente. Data della registrazione: 07/09/1967.



Scorcio panoramico di Torremezzo di Falconara
(fine anni '80 del XX secolo)

PICA

Një dít e jëma i tha të birit:

“E qëll një píc tit et?”

“Ëgh!”

“Ec ka nj’ án e ka nj’ án, dopu ec ndë mest e ndë mest e arrivarën te jit át...”

Allura kur zú e kërceu, ai ghëngri picën ka nj’ án e ka nj’ án, dopu mori e sa e ghëngri ndë mest e ndë mest... Dopu arrivarti te i jati. I tha kij:

“Më solle picën?”

I biri i rispundirti:

“U nëng t’e solla se mëma m’ tha ka kish t’e ghanj ka nj’ án e ka nj’ án e ndë mest e ndë mest... e u e ghëngra”.

Narratore: Alberto Gnisci. Paese: Falconara Albanese. Età: 9 anni. Istruzione: III elementare. Genitori: ambedue albanesi. Professione: studente. Data della registrazione: 07/09/1967.

TRE ÇIÇAT

Një dít i jati ish e shërben e i tha djalit:

“Ec e zij një dí a tre çiqëra”.

“Ëgh” tha djali e vate.

Vate e ziti tre çiqëra. Dopu nj’ cík vate i provarti e ghëngërti një. Dopu njetër cík vate e ghëngërti njetër çiqër e e la na metà. Kur dopu i jati i thirri:

“U bën çiqrat ë?”

I biri i rispundirti:

“Ëgh, ëgh” e i tój gjith ata új.

I jati tha:

“E u të thaç se t’ bënji shum!”

Ai i rispundirti:

“E ti m’ thé tre çiqëra”

Narratore: Alberto Gnisci. Paese: Falconara Albanese. Età: 9 anni. Istruzione: III elementare. Genitori: ambedue albanesi. Professione: studente. Data della registrazione: 07/09/1967.

KOSTANDINI I VOGËLITH

Një ghër ish Kostandini i vogëlith, trí dít dhëndërr ish. Mò' i erdhi kartelja m'u vate sulldát. Nusezës çë ki' marrur allura i tha:

“Prit nënd e prit dhjët vjet e pëstaj merr e ju martou”.

E kij vate sulldat te rregji.

Kjo nusja psajna priti nënd e priti dhjët vjet, Kostandini nëng erdhi, e mori i Samendár për búrr. Mori Samëndarin se kish t' martonçin.

Kostandini, i meruëmi, ghoq e dha atéjza një shartim. Ju gjegj rregji e tha:

“Kuji kjén shartimet sonde?”

“M' kje mua, t' mjerit, zot, se ajo e bukura, ajo sot më vete nuse...”

“E u t' jap zgjdh” tha “më t' mirin kal, më të zirin se ulliri. Merr shpejt t'i ghipç kalit e ec e gjëj nusezën!”

Ai i ghipi kalit e vate, i meruëmi, vate në katund e gjën Filarén, të jatín, t' veshur kollogrez. Tha:

“Oj ti zoti kollogréz, mos e di ku bënen dazëm?”

“Mos më pijëj për këto dazëm, se kjo zonja, ime ré, ajo sot më vete nuse”.

Pësáj i vete e jëma. Tha:

“Oj ti zonja kollogré, mos e di ku bënen dazëm?”

“Mos më pijëj për këto dazëm, se kjo zonja, ime ré, ajo sot më vete nuse”.

Dopu i pijën motrat:

“O ju zonjëra kollogréze, mos dini ku bënen dazëm?”

“Mos na piëni për këto dazëm, se ajo motra, kunata jón, ajo sot na vete nuse”.

Allora kij vate n' katund e pá se ín e shkójn likuërt e i tha:

“Ëmni qelqín me vér, sa t' i falenj kësáj nuse”.

Ato ja dhán. Kij ghòj kurorën e pár ndë vért. Pijti një cík vér e ja dha asáj, nuses. Ajo pá kurorën ndë vért, e njoghu e tha:

